



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI KOMBËTAR I SHKENCËS

NACIONALNI SAVET ZA NAUKU

NATIONAL RESEARCH COUNCIL

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

Prishtine, mars 2010

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

Këshilli Kombëtar i Shkencës

Kryetar:

Akademik Rexhep Ismajli

Sekretar:

Dr. Dukagjin Pupovci

Anëtarë:

Dr. Avdyl Krasniqi

Dr. Fetah Podvorica

Dr. Isuf Krasniqi

Dr. Jahja Drançolli

Dr. Husnija Bibuljica

Dr. Nexhmi Rexha

Dr. Radivoje Man i

Akademik Rexhep Ferri

Dr. Skender Kaçiu

Dr. Suzana Kërliu

Dr. Xhevat Perjuci

Dr. Zejnullah Gruda

Dr. Zejnullah Rrahmani

Ky dokument u miratua nga Këshilli Kombëtar i Shkencës në mbledhjen e mbajtur me 30 mars 2010.

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Shkurtesat | 4 |
| Përmbledhje ekzekutive..... | 5 |
| 1. Hyrje dhe mirënjohje..... | 8 |
| 2. Gjendja e kërkimeve dhe e zhvillimit në Kosovë..... | 10 |
| 3. Objektivi politik, qëllimi dhe synimet..... | 15 |
| 4. Caktimi i prioriteteve të kërkimit shkencor e të zhvillimit në Kosovë | 20 |
| 4.1. Arsyeshmëria e vendosjes së prioriteteve..... | 20 |
| 4.2. Procesi i vendosjes së prioriteteve..... | 22 |
| 4.3. Instrumentet e mundshme për përdorim në Politikat e Sh & T..... | 23 |
| 5. Zhvillimi i pesë plus një prioriteteve të Këshillit Kombëtar të Shkencës në Kosovë | 27 |
| 5.1. Parathënie | 27 |
| 5.2. Prioriteti 1: Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi..... | 28 |
| 5.3. Prioriteti 2: Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit..... | 30 |
| 5.4. Prioriteti 3: Kërkimet shkencore në mjekësi | 31 |
| 5.5. Prioriteti 4: Studimet shoqërore dhe ekonomike..... | 33 |
| 5.6. Prioriteti 5: Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike | 35 |
| 5.7. Studime ndër-horizontale në Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese | 37 |
| 5.8. Korniza ndërkombëtare për prioritetet kombëtare shkencore dhe zhvillimore të Kosovës | 39 |
| 6. Plani Zbatues | 41 |
| 6.1. Plani i aktiviteteve dhe orari..... | 41 |
| 6.2. Buxheti | 47 |
| 6.3. Sfidat kryesore operative..... | 52 |
| Shtojca 1: Lista e ekspertëve që kanë marrë pjesë në hartimin e Programit..... | 54 |
| Aneksi 2: Literatura..... | 55 |

Shkurtesat

| | |
|----------|---|
| ASO | Zyra Ndërlidhëse e Austrisë për Shkencë dhe Kërkime |
| CEEPUS | Programi i Shkëmbimeve i Evropës Qendrore për Studime Universitare |
| CIP | Programi Kornizë për konkurrencë dhe inovacion |
| QITT | Qendra për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë |
| QeP | Qendra e Përsosmërisë |
| COST | Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji |
| DFID | Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar |
| BE | Bashkimi Evropian |
| FP7 | Programi Kornizë FP7 |
| BPV | Bruto Produkti Vendor |
| TIK | Teknologjia Informative dhe Komunikuese |
| IT/TI- | Teknologjia informative |
| QKBNSHT | Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Shkencë dhe Teknologji |
| KAIP | Partneriteti Kosovë-Austri në fushën e Arsimit të Lartë dhe Shkencës |
| MASHT | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë |
| OJQ | Organizatata joqeveritare |
| KKSH | Këshilli Kombëtar i Shkencës |
| PhD | Philosophiae Doctor |
| K&ZH | Kërkime dhe Zhvillim |
| KZhT | Kërkime dhe Zhvillim Teknologjik |
| KZhTI | Kërkime, Zhvillim Teknologjik dhe Inovacion |
| Sh&T | Shkenca dhe Teknologjia |
| NVM | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |
| ToR | Termet e Referencës |
| UNFPA | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullacion |
| UNICEF | Fondi Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë |
| UP | Universiteti i Prishtinës |
| USAID | Agjencia e ShBA për Zhvillim Ndërkombëtar |
| OBSh | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| WINS-ICT | Përkrahja e Inco-Net në fushën e TIK-ut për vendet e Ballkanit Perëndimor , |
| WUS | Shërbimi Universitar i Botës |

Përmbledhje ekzekutive

Në bazë të Ligjit nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Programi Kombëtar i Shkencës duhet të synojë, ndër të tjera, që të punojë për identifikimin e prioriteteve shkencore, për të krijuar kushte për investime infrastrukturore, për të forcuar pjesëmarrjen në projektet ndërkombëtare kërkimore-shkencore dhe për të përpunuar një program sistematik arsimor për hulumtues. Programi Kombëtar i Shkencës duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës për një periudhë pesëvjeçare, i cili, gjithashtu, duhet të sigurojë fonde për realizimin e programit të propozuar nga Qeveria.

Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik (KZhT) është ende një ndërmarrje marginale në Kosovë. Mungojnë edhe kërkimi bazik dhe statistikatat teknologjike. Ende nuk ekziston një sistem funksional dhe i qëllimshëm i risimitarisë (inovacionit). Arsyt kryesore për këtë mangësi ishin përjashtimi i imponuar i komunitetit akademik dhe të kërkimit shkencor në periudhën e para-luftës, kur personeli akademik i tanishëm ishte i izoluar nga zhvillimet ndërkombëtare shkencore; shkatërrimet materiale dhe jomateriale gjatë luftës; dhe, më pas, një proces i vështirë i rimëkëmbjes ekonomike. Deri vonë, shpenzimet e përgjithshme për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim (K&ZH) në Kosovë ishin vetëm rreth 0.1% të BPV-së. Kjo përqindje është ndjeshëm nën mesataren evropiane, dhe madje edhe më poshtë mesatares së shteteve fqinje në rajon, si dhe të shumë vendeve në zhvillim. Dija absorbuese dhe kapacitetet teknologjike në Kosovë janë ndjeshëm të kufizuara, si në numër, ashtu edhe në shtrirje dhe në cilësi. Arsye për këtë deficit është mungesa e financimit të veprimtarive kërkimore dhe të zhvillimit teknologjik (KZhT) për të paktën 20 vjetët e fundit. Pa një financim të mjaftueshëm të KZhT-së, nuk mund të thuhet se kapacitetet përthithëse të mundshme në ekonomi dhe komunitetin akademik në Kosovë shfrytëzohen në nivel të kënaqshëm dhe as që janë në gjendje për të përballuar me sukses progresin teknologjik.

Programi i tanishëm Kombëtar i Shkencës i Kosovës ka për qëllim të neutralizojë këto deficite duke ofruar një kornizë konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë. Qartazi, sektori kërkimor në vetvete nuk është përfituesi i vetëm i kësaj qasjeje, por edhe fushat e tjera të politikave, si politikat ekonomike, politikat shëndetësore, politikat e mjedisit, politikat bujqësore, planifikimi urban dhe rural, politika e jashtme dhe politika e integritimit evropian, të gjitha këto do të përfitojnë menjëherë nga një bazë e përmirësuar e njohurisë të kapaciteteve kërkimore të Kosovës. Në këtë kuptim, KZhT nuk është një qëllim në vetvete, por është një lehtësues për bërjen e politikave të bazuara në fakte në shumë sfera të tjera shoqërore, ekonomike dhe ekologjike në Kosovë.

Synimet specifike të shkencës dhe teknologjisë (Sh&T), të cilat janë të nevojshme për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës drejt një Shoqërie të Dijes, në linjë me bashkëveprimin e bazuar në fakte ndërmjet shkencave bazike, qytetarëve dhe biznesit, janë:

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore- shkencore

Objektivi 2: Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

Objektivi 4: Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Objektivi 5: Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore

Është e vetëkuptueshme se pesë objektivat kanë lidhshmëri të madhe me njëri-tjetrin dhe, kështu nuk duhet të trajtohen si të izoluar, por në mënyrë sistemore. Për secilin objektiv janë përshkruar synimet, si dhe aktivitetet e nevojshme për arritjen e tyre.

Prioritetet kombëtare shkencore janë identifikuar përmes një procesi me pjesëmarrje në të cilin kërkohet rrugë për kanalizimin e fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare për KZhT. Radhitja e prioriteteve të identifikuara kombëtare në Kosovë reflekton etje gjenerike për zënie të hapit në shkencë dhe teknologji (Sh&T) përmes disiplinave të ndryshme. Përmes kësaj qasjeje mund të sigurohet masa kritike për krijimin e kapaciteteve përthithëse të KZhT-së për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës. Ekipi Planifikues u pajtua rreth gjashte kritereve për caktimin e prioriteteve:

- Rëndësia për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit,
- Numri dhe cilësia e burimeve njerëzore në vend dhe në diasporë,
- Kushtet e infrastrukturës kërkimore shkencore,
- Kontributi për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar të Kosovës,
- Ekzistimi i potencialit për arritjen e rezultateve kërkimore-shkencore dhe zbatimin e tyre brenda dhe jashtë,
- Ekzistimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e caktuar.

Fillimisht janë analizuar 33 fusha dhe është krijuar një listë prej 16 prioriteteve potenciale hulumtuese. Diskutimet vijuese rezultuan me caktimin e pesë prioriteteve të mëposhtme:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit.
3. Kërkimet shkencore në mjekësi
4. Studimet shoqërore dhe ekonomike
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Përveç kësaj, fusha e Teknologjisë Informative dhe Komunikuese konsiderohet si prioritet ndër-horizontal që mund të shfaqet në cilëndo nga fushat e lartpërmendura.

Pozicioni i Këshillit Kombëtar të Shkencës është se disiplinat që nuk janë radhitur në këto fusha prioritare, duhet të përfitojnë nga fondi i programeve kërkimore-shkencore i funksionalizuar nga Qeveria, duke trimëruar aktivitetin kërkimor-shkencor në këto fusha. Sidoqoftë, fushat prioritare duhet të marrin mbështetje shtesë nga Qeveria, sektori publik dhe privat në vend, ngase kërkimi shkencor në këto fusha kontribuon drejtpërdrejtë në zhvillimin e vendit.


Që kur Programi Evropian Kornizë për KZhT është bërë burim i rëndësishëm financimi për shumë vende të Evropës Juglindore (të emërtuar “Vendet e Ballkanit Perëndimor”), dhe me shpresë që, në një të ardhme të afërt, të bëhet burim edhe për Kosovën, është me rëndësi që caktimi i prioriteteve në Kosovë të mos jetë në kundërtë me rrjedhat kryesore Evropiane dhe botërore sa i përket financimit të KZhT-së. Krahasimi ynë tregon se nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë. Lidhshmëria e qartë tematike vërehet në prioriteteve 1-4. Përveç faktit se, në shumë aspekte, teorikisht ekziston lidhshmëria me programin më të madh në botë për KZhT, nuk duhet ta nënvlerësojmë rrezikun që niveli i ulët i kërkimit në Kosovë mund të vështirësojë përfshirjen më të madhe të hulumtuesve kosovarë në rrjetet hulumtuese evropiane dhe botërore.

Nga këndvështrimi i potencialit të tyre për të mundësuar lidhjen bilaterale me programet kërkimore të vendeve të tjera, të gjitha prioriteteve kombëtare të identifikuara të KZhT-së në Kosovë janë shpresëdhënëse. Pothuaj se nuk ka vend evropian që nuk vë theks të veçantë te TIK, hulumtimet në mjekësi, mjedis dhe energji ose që nuk vë theks në bujqësi apo sigurinë e ushqimit, shkenca shoqërore (posaçërisht studimet që prekin ndryshimet shoqërore drejt të ashtuquajturës shoqëri e bazuar në dije) dhe shkenca humane. Kështu, është dhënë një bazë e mirë për ndërtimin e programeve bilaterale ndërqeveritare në Sh&T. Lidhja e fortë e gjuhës

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

shqipe dhe e kulturës shqiptare, sidoqoftë, mund të trajtohet më së miri përmes një bashkëpunimi të ngushtë me shtetet fqinje si Maqedonia dhe Shqipëria, më të cilat marrëveshjet për Sh&T tanimë ekzistojnë.

Programi Kombëtar i Shkencës, gjithashtu, përmban planin e zbatimit që tregon përgjegjësinë për zbatim, orarin e zbatimit dhe buxhetet për secilin aktivitet të planifikuar. Buxheti i nevojshëm për të implementuar aktivitetet e përcaktuara në këtë Program Kombëtar të Shkencës, me qëllim të arritjes së objektivave të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe qenies në funksion të prioriteteve të identifikuara, karakterizohet me ngritje mjaft të madhe vjetore (shih grafikun e dhënë më poshtë). Me supozimin se instrumentet e prezantuara, të cilat kanë vlera të përgjithshme strukturore (siç janë shpërblimet për hulumtuesit më të mirë kosovarë, programet vjetore afatshkurtra të mobilitetit, fondi vjetor “kthimi i trurit”, fondi vjetor për publikime, qasja vjetore në biblioteka elektronike, fondi vjetor për përgatitjen e projekteve për FP7, fondi vjetor për sistemin informativ të KZhT, grantet vjetore për projekte ndërkombëtare, buxheti vjetor për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin, bursat vjetore për studime pasdoktorale), vazhdojnë të jenë në veprim edhe pas vitit 2015 (sidoqoftë, pa nisma të reja), atëherë lartësia e buxhetit do të stabilizohej midis 4.5 dhe 6.5 milion euro në vit, siç është treguar edhe në grafikun e mëposhtëm.



1. Hyrje dhe mirënjohje

Korniza ligjore e KZHT-së në Kosovë në përgjithësi, si dhe për Programin Kombëtar të Shkencës në veçanti është dhënë me Ligjin Nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore Shkencore të dekretuar në vitin 2004. Ligji (Kuvendi i Kosovës, 2004) përmban dy nene për Programin Kombëtar të Shkencës të Kosovës (neni 51 dhe 52). Programi Kombëtar i Shkencës duhet të synojë, mes tjerash, të punojë për identifikimin e prioriteteve kërkimore-shkencore, të krijojë kushte për investime infrastrukturore, të forcojë pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore të nivelit ndërkombëtar dhe të ndërtojë një program të edukimit sistematik për hulumtuesit. Programi Kombëtar i Shkencës duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës për një periudhë prej pesë vjetësh. Kuvendi, gjithashtu duhet të sigurojë fonde për realizimin e programit të propozuar nga Qeveria.

Ligji jep hapësirë veprimi jo vetëm për skemat klasike të fondeve kërkimore, por edhe për skemat me orientim më shumë strukturor apo me përmasa ndërkombëtare. Neni 60 përcakton se projektet mund të paraqiten si (a) projekte kërkimore-shkencore, (b) projekte zhvillimore dhe (c) projekte të zhvillimit të infrastrukturës.

Kriteret e përgjithshme për pranimin dhe vlerësimin e projektit janë (neni 62):

- (a) rëndësia e projektit për zhvillimin e Kosovës,
- (b) vlera shkencore dhe përmasat ndërkombëtare të projektit,
- (c) arritjet shkencore të bartësit të projektit,
- (d) kompetenca e organizatës aplikuese,
- (e) përshtatshmëria ekologjike e projektit.

Ligji parasheh që zbatimi i Programit Kombëtar të Shkencës të jetë përgjegjësi e një këshilli shkencor përkatësisht këshillave (për shembull, lidhur me vlerësimin e projektit; dorëzimin e propozim-projekteve, etj) themeluar nga Qeveria (neni 58 dhe 59). Nga ana tjetër, kjo është përgjegjësi e MASHT-it në aspektin e shpalljes së konkursit, marrjes së vendimeve përfundimtare për financim dhe kontraktim (shih nenin 60, nenin 63 dhe nenin 65). Vetë Ligji nuk e parasheh themelimin e një agjencie të specializuar për të zbatuar programin/et e K&ZH-së.

Këshilli Kombëtar i Shkencës (KKSH) është themeluar në bazë të nenit 53 të Ligjit. Këshilli dhe 15 anëtarët e tij u emëruan në seancën plenare të Kuvendit të datës 12 korrik 2007, kurse u konstituua dhe organet e veta i zgjodhi më 20 dhe 22 tetor 2008. Detyrat e KKSH-së dhe organeve të tij janë të përcaktuara më ligjin e lartpërmendur.

Zhvillimi i Programit Kombëtar të Shkencës ishte një nga detyrat më të rëndësishme të KKSH-së në vitin 2009. Me gjithë vonesat e natyrës administrative dhe faktin se ky është program i parë i këtij lloji i zhvilluar ndonjëherë në Kosovë, Këshilli arriti të dalë me një dokument që tregon rrugën për konsolidimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në Kosovë, duke e ndërlidhur atë me nevojat zhvillimore të vendit. Kryerja e kësaj pune do të kishte qenë e pamundur pa mbështetjen e institucioneve të Kosovës, partnerëve zhvillimorë, si dhe ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Këshilli dëshiron të falënderojë në veçanti:

- Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT) dhe ministrin, dr. Enver Hoxhaj, për mbështetje të vazhdueshme të procesit, këshilla të çmuara, dhe koordinimin e bërë me Këshillin;

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

- Projektin e Partneritetit Kosovë-Austri në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës (KAIP) dhe drejtorin e projektit, dr. Johann Guenther, për ofrimin e ekspertizës ndërkombëtare dhe financimin bujar të procesit të planifikimit dhe të konsultimit;
- Dr. Klaus Schuch, ekspert i politikave shkencore, për kontributin e çmueshëm në procesin e zhvillimit dhe të shkrimit;
- Të gjithë ekspertet ndërkombëtarë dhe kosovarë që kanë kontribuar në çfarëdo mënyre për zhvillimin dhe diskutimin e Programit Kombëtar të Shkencës;
- Personelin e MASHT-it dhe KAIP-it të cilët ofruan ndihmë logjistike për aktivitetet për zhvillimin e Programit.

2. Gjendja e kërkimeve dhe e zhvillimit në Kosovë

Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik (KZhT) është ende një ndërmarrje margjinale në Kosovë. Mungojnë edhe kërkimi bazik dhe statistikat teknologjike. Ende nuk ekziston një sistem funksional dhe i qëllimshëm i inovacionit¹. Arsyet kryesore për këtë mangësi ishin përjashtimi i imponuar i komunitetit akademik dhe i kërkimit shkencor në periudhën e para-luftës, kur personeli akademik i tanishëm ishte i izoluar nga zhvillimet ndërkombëtare shkencore; shkatërrimet materiale dhe jomateriale gjatë luftës; dhe, më pas, një proces i vështirë i rimëkëmbjes ekonomike. Deri vonë, shpenzimet e përgjithshme për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim (K&ZH) në Kosovë ishin vetëm rreth 0.1% të BPV-së. Kjo përqindje është ndjeshëm nën mesataren evropiane dhe, madje, edhe më poshtë mesatares së shteteve fqinje në rajon, si dhe të shumë vendeve në zhvillim. Megjithatë, MASHT-i dhe universitetet, si dhe institucionet kërkimore jouniversitare, janë të vetëdijshme se KZhT duhet të bëhet së shpejti pjesë integrale e sistemit të arsimit të lartë (si është përshkruar në Strategjinë e Arsimit të Lartë) dhe, për më tepër, duhet të jetë me rëndësi jetike për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Nuk ka dyshim se në diskutet e politikave ndërkombëtare, qasja tek dija dhe kapaciteti për ta shndërruar dijen në përfitime sociale dhe ekonomike paraqet një vijë të qartë ndarëse në mes vendeve që kanë dhe atyre që nuk kanë. Prandaj, KZhT (dhe gjithnjë e më shumë kuptimi i inovacionit) janë gjithnjë në agjendën politike. Prioritetet për KZhT të identifikuar në këtë Program Kombëtar të Shkencës paraqesin tregues të nevojshëm strukturorë për të orientuar, bashkërenduar dhe kontrolluar alokimin e fondeve për kërkime, ose, të paktën, për të penguar alokime që nuk janë efektive dhe nuk janë kritike, në kuptim të rëndësisë për shoqërinë dhe ekonominë.

Si në Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Kuvendi i Kosovës, 2004), ashtu edhe në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit të Lartë të MASHT-it (MASHT, 2004), sektorit universitar publik i kushtohet vëmendje e veçantë dhe i atribuohet përgjegjësia për zhvillimin e aktiviteteve kërkimore. Ndër objektiva të tjerë, Ligji për Arsimin e Lartë përcakton qëllimin që të krijohet, zhvillojë, mbrojë dhe transmetojë njohuri përmes mësimdhënies dhe punës shkencore dhe hulumtuese (neni 2.1.) (Kuvendi i Kosovës, 2002). MASHT (MASHT, 2004) sqaron vizionin për arsimin e lartë në Kosovë, ku “njohuritë dhe kërkimi shkencor janë në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm kulturor, shoqëror, dhe ekonomik” (f. 6). Statuti i Universitetit të Prishtinës (UP) e pasqyron këtë vizion duke deklaruar se ai synon të jetë një qendër kryesore për avancimin e njohurive, ideve dhe shkencës në arsimin e lartë. Ky qëllim është konfirmuar edhe më “Strategjinë e UP për vitet 2009-2013”, e cila u publikua kohën e fundit (UP 2009).

Në përgjithësi, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë është i periudhës para Humboldt dhe karakterizohet me marginalizimin e kërkimeve shkencore. Kjo diagnozë vlen për tërë sektorin, përfshirë këtu edhe Universitetin e Mitrovicës dhe Universitetin e Prishtinës, i cili është edhe institucioni me i madh në Kosovë i orientuar në hulumtime shkencore (shih Tahirsylaj, që citon Mustafën; të dy në 2004; Raportin e vetëvlerësimit të UP-së, 2008; evidentuar në analizën bibliometrike që është zhvilluar në kuadrin e një projekti konsultues të organizuar nga OSBE-ja në vitin 2008). Në nenet 171-175 të Statutit të Universitetit të Prishtinës është përshkruar shkurtimisht raporti i universitetit ndaj kërkimeve shkencore dhe

¹Ky tekst është bazuar në Raportin Tematik “Shkenca dhe Teknologjia në Kosovë /UNMIK” hartuar nga Klaus Schuch dhe publikuar nga Zyra për Informim e Platformës Drejtuese për Kërkime në vendet e Ballkanit Perëndimor, redaktuar nga Elke Dall (2008): Shkenca dhe Teknologjia në Ballkanin Perëndimor, Barrister & Principal

bursave. Këtu është përcaktuar një tipar i qartë i instrumentit drejtues për hulumtime shkencore në dobi të mësimdhënies dhe të trajnimit. Neni 171 thotë se universiteti duhet të kryejë hulumtime shkencore dhe punë artistike, me qëllim të përkrahjes së zhvillimit të proceseve edukative, për t'i njohur studentët me hulumtime shkencore dhe punë artistike, për zhvillimin e profesionistëve të rinj shkencorë dhe artistikë, për të krijuar një rrjet ndërkombëtar të studiuesve dhe artistëve dhe për t'i përgatitur ata që të kryejnë kërkime ndërdisiplinore konkurrense dhe projekte të artit (Universiteti i Prishtinës, 2004).

Neni 171, ndër të tjera, u referohet kërkimeve bazike pa zbatim të menjëhershëm praktik si dhe kërkimeve të zbatuara që lidhen ngushtë me interesin publik dhe nevojat publike, të dyja këto me financim nga fondet publike të Universitetit ose nga fonde private nga kontratat individuale me persona të tretë. Neni 172 obligon Universitetin të sigurojë kushte të përshtatshme për kërkime shkencore për të arritur rezultate konkurruese në nivel ndërkombëtar, por, gjithashtu, kërkon nga stafi akademik që të kryejnë kërkime shkencore si dhe parashih që performanca individuale në lidhje me kërkimin shkencor të merret parasysh për vlerësimin profesional dhe avancim në karrierë. Në harmoni me statutet e universiteteve bashkëkohore, neni 173 konfirmon se kërkimi shkencor duhet të kryhet brenda objekteve të universitetit dhe se rektori mund të japë leje për stafin akademik për të kryer hulumtime në lokacione të përcaktuara jashtë universitetit dhe për të marrë pjesë në projekte bashkëpunimi me institucione të tjera (Universiteti i Prishtinës, 2004). Kjo është me rëndësi të veçantë për pjesëmarrjen në Programet Evropiane Kornizë për KZhT dhe në programe të tjera ndërkombëtare të KZhT. Neni 174 merret me raportimin e aktivitetit të hulumtimit shkencor dhe neni 175 me vitin e lirë studimor.

Më qëllim të tejkalimit të nivelit para-Humboldtian të arsimit të lartë, dhe të hendekut në mes të vizionit dhe të realitetit, UP ka zhvilluar një udhërrëfyes dhe një strategji të re, dhe të dyja këto theksojnë vlerën e kërkimit shkencor. Sidoqoftë, për të përmirësuar gjendjen në mënyrë sistematike, është thelbësore të krijohet një institucion kombëtar, ku stafi akademik i motivuar për t'u angazhuar në hulumtime shkencore do të mund të aplikonte për financim të aktivitetit hulumtues.

Bazuar në kërkesat specifike të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore–Shkencore (neni 21) edhe institutet private kanë të drejtë të kryejnë punë kërkimore dhe mund të marrin fonde për këtë qëllim (Kuvendi i Kosovës, 2002). Këshilli Kombëtar i Shkencës është përgjegjës për të dhënë mendim në lidhje me përmbushjen e standardeve për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në institutet private shkencore (neni 21,2) dhe MASHT-i ka kompetencë për të licencuar (pas një opinioni pozitiv) dhe për të regjistruar institutet private shkencore në Regjistrin e instituteve kërkimore-shkencore (neni 23). Ata pastaj duhet të t'i shtojnë emrit të vet shenjën "me të drejtë publike" (neni 24).

Sidoqoftë, vetëm tri entitete publike kërkimore-shkencore janë numëruar në mënyrë eksplicite në Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (Kuvendi i Kosovës, 2004a), edhe atë (neni 69,2):

- a) Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës,
- b) Instituti Albanologjik dhe Instituti i Historisë si institute kërkimore shkencore,
- c) Universitetet (duke përcaktuar me nenin 13 se institutet kërkimore shkencore të themeluara brenda institucioneve të arsimit të lartë janë në përbërje të institucioneve në fjalë).

Qëllimi kryesor (neni 6) i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve është që të nxisë të menduarit shkencor dhe krijimtarinë artistike me:

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

- të qenit institucion konsultativ për zhvillimin e shkencës dhe të artit në përputhje me nevojat e zhvillimit të Kosovës,
- vlerësimin e rrethanave ekzistuese dhe propozimin e masave për të avancuar të menduarit shkencor dhe për ngritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike,
- shqyrtimin e problemeve të përgjithshme në fushat e veprimtarisë shkencore dhe të krijimtarisë artistike,
- pjesëmarrjen në ndërtimin e politikave për veprimtari shkencore dhe krijimtari artistike,
- organizimin e ngjarjeve shkencore dhe kulturore,
- publikimin e botimeve të veta të rregullta dhe periodike,
- zhvillimin e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar,
- krijimin e kushteve për shkëmbimin e të menduarit shkencor dhe të krijimtarisë artistike me jashtë, dhe
- përmirësimin e kushteve të punës për anëtarët e Akademisë.

Pas Akademisë së Shkencave, Instituti Albanologjik në Prishtinë ka reputacionin më të lartë si një institut kërkimor–shkencore jo-universitar në Kosovë. Është një institucion kërkimor i pavarur publik që studion "*kulturën shpirtërore dhe materiale të kombit shqiptar*" (Instituti Albanologjik, 2007a). Instituti i Historisë i Kosovës është po ashtu institucion kërkimor i pavarur publik me rëndësi të madhe për zhvillimet e shkencës në fushat me të cilat merret.

Çështjet e tjera të rëndësishme që trajton Ligji për Veprimtarinë Kërkimore–Shkencore (Kuvendi i Kosovës, 2004) kanë të bëjnë me një tendencë të qëllimshme për vënien e aktiviteteve kërkimore–shkencore në funksion të zhvillimit të prosperitetit ekonomik (neni 2) duke adresuar të tri skemat kryesore të kërkimit shkencor: kërkimet fundamentale, aplikative dhe zhvillimore (neni 3). Është me rëndësi që, në nenin 6, kërkimi shkencor u referohet çështjeve të tjera të përbashkëta, siç janë: liria e kërkimit shkencor dhe e krijimtarisë ose e përfshirjes në veprimtarinë shkencore ndërkombëtare - parimi i punës publike (me një dispozitë të nenit 48 për statusin e studiuesit si nëpunës civil), financimit konkurrues (të paktën pjesërisht) dhe korrelacionit të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë, që përcakton rëndësinë e zhvillimit të veprimtarisë shkencore në universitete.

Ligji gjithashtu thekson se nga Buxheti i Kosovës më qëllim të përmbushjes së kushteve të nevojshme për kërkime shkencore dhe për të siguruar mjetet për të ndërmarrë aktivitete hulumtuese shkencore duhet të ndahen deri në 0.7%. Përveç kësaj, thekson se buxheti mund të përdoret gjithashtu për të mbuluar shpenzimet që lidhen me zbatimin e njohurive dhe procesin e shpërndarjes së njohurive, të cilat karakterizojnë sistemet e hulumtimit gjithëpërfshirës (Borsi, 2004).

Është gjithashtu e rëndësishme që ligji promovon avancimin dhe trajnimin e personelit të ri në fushën e K&Zh (për shembull, neni 19 dhe neni 50), që ka një peshë të veçantë, për shkak të mungesës së kapaciteteve bashkëkohore për kërkime shkencore. Krahas fondeve publike, institutet kërkimore shkencore kanë të drejtën të marrin mjete edhe nga fonde të tjera, fondacionet dhe donacionet, nga burime të tjera të ligjshme (duke supozuar se edhe ndërmarrjet bëjnë pjesë në këtë kategori), si dhe nga mjetet e tjera të realizuara nga institucionet kërkimore shkencore (për shembull licencimi i njohurive të mbrojtura) (neni 66). Në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Kosovë (Kuvendi i Kosovës, 2002), është përcaktuar se universiteti publik, në parim, është i lirë të marrë çdo masë për të nxitur dhe shfrytëzuar në mënyrë komerciale aktivitetet e tij kërkimore për përfitime të veta (neni 21,1). Sidoqoftë, nëse

një aktivitet i tillë përfshin veprimtarinë komerciale, ose, potencialisht, mund të përfshijë, shfrytëzimin e ndonjë të drejte të rëndësishme të pronësisë intelektuale në punën letrare, artistike ose shkencore, zbulime shkencore, dizajn, shpikje, materiale, mallra apo shërbime të ofruara tërësisht ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga fondet publike, ofruesi paraprakisht duhet të kërkojë miratimin e Ministrisë (neni 21.2). Neni 23.1 vërteton se bartësit e akredituar të arsimit të lartë privat gjithashtu mund të marrin fonde të alokuara nga Ministria për mësimdhënie ose kërkime shkencore me interes publik.

Përveç Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, Ligji Nr 2004/19 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i miratuar në 2004, dhe Ligjit Nr 2002/3 për Arsimin e Lartë, i miratuar në vitin 2002 dhe i dekretuar në maj të vitit 2003, si dhe një varg i ligjeve të tjera, ndikojnë, më shumë ose më pak, në veprimtarinë kërkimore shkencore, për shembull:

- Ligji për Produkte Mjekësore dhe Pajisje Mjekësore (Nr. 2003/26 i dt. 4 dhjetor 2003 dekretuar më 7 korrik 2004)
- Ligji mbi drejtat e autorit dhe të drejtat të tjera të përafërta (Nr. 2004/45 i dt. 29 qershor 2006, dekretuar më 24 gusht 2006)
- Ligji për Patentim (Nr. 2004/49 i dt. 27 shtator 2004, dekretuar më 21 dhjetor 2004) dhe ndryshuar me ligjin 02/L-100 të dt. 18 dhjetor 2006 dhe dekretuar më 6 shkurt 2007)
- Ligji për përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (Nr. 2005/44 i dt. 23 marsi 2005, dekretuar më 8 shtator 2005)
- Ligji për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (Nr. 02/L-20 i dt. 24 qershor 2005, dekretuar më 21 korrik 2005)
- Ligji për akreditim (Nr. 02/L-43 i dt. 21 nëntor 2005, dekretuar më 21 prill 2006)
- Ligji për metrologji (Nr. 02/L-61 i dt. 19 janar 2006, dekretuar më 22 prill 2006)
- Ligji për veprimtarinë botuese dhe librin (Nr. 02/L-51 i dt. 16 mars 2006, dekretuar më 21 prill 2006)
- Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Nr. DL-006/2009 i dt. 26 shkurt 2009, dekretuar më 19 mars 2009) etj

Në kohën e shkrimit, disa ligje të tjera përkatëse nuk ishin miratuar ende, si “Ligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht” ose “Ligji për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare”. Përveç kësaj, ka disa udhëzime administrative të nxjerra nga MASHT-i, si ai për "Këshillin Qendror të Shkencës" (nr. 19/2006 i dt. 31 maj 2006) dhe për “Caktimin e standardeve në shkencë” (nr. 20/2006 i dt. 31 maj 2006). I pari shtjellon dispozitat ligjore për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës, ndërsa i fundit përcakton kriteret për emërimin në titujt hulumtues.

Pavarësisht nga zhvillimet shumë pozitive në vitet dhe në muajt e fundit, Kosova është në fillim të ngritjes së një sistemi të mirëfilltë kërkimor shkencor. Kështu, përqendrimi në disa pika fillestare është thelbësor dhe duhet të trajtohet me kujdes të madh. Në vend të propozimit të politikave të përealizueshme "broadband" në shkencë dhe në teknologji, ky Program Kombëtar i Shkencës, që në fillim, thekson nevojën për një ndërveprim të fortë me objektivat e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik dhe përqendrohet në disa prioritete tematike. Nëse kërkimet e para shkencore janë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave të ekonomisë dhe të shoqërisë, atëherë sektori do të fitojë rëndësi dhe njohje, dhe do të hidhet fara për arritje më të madhe shkencore në ekonomi dhe në shoqëri. Sidoqoftë, fillimisht, kërkimi shkencor duhet të kontribuojë në rritjen ekonomike dhe mirëqenien sociale para se të bëhet vetë përfitues i

rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale. Qysh në fillim, duhet të merret parasysh dimensionin ndërkombëtar. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore dhe zhvillimi i teknologjisë në Kosovë nuk duhet të kufizohet vetëm në çështjen e transferit të teknologjisë, përkundër rëndësisë së tij të brendshme për rritje të shpejtë ekonomike. Shembujt e vendeve të tjera në rajonin e Evropës Juglindore kanë treguar se ç' rëndësi ka pjesëmarrja në Programin Evropian Kornizë për K&Zh për adoptimin e metodave bashkëkohore shkencore dhe të diturisë me qëllim të krijimit të pikave lidhëse për zhvillimin e mëtejshëm të gjendjes drejt përsosmërisë. Por edhe adoptimi i çështjeve strukturore, për shembull, përmes ndërtimit të proceseve transparente në kuptimin e konkurseve për propozime dhe prezantimin e standardeve të vlerësimit, si dhe adoptimi i standardeve menaxhuese të kërkimit shkencor mund të konsiderohen si elemente thelbësore për të ndihmuar vetveten dhe për të arritur përmirësimin e vazhdueshëm të performancës (e ashtuquajtura vlerë e shtuar e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar). Këto aspekte, megjithatë, nuk janë të kufizuara vetëm tek Programi Evropian Kornizë për K&ZhT, por janë gjithashtu të rëndësishme për shumë programe të tjera multilaterale dhe nisma si: CEEPUS, CIP ose COST, si dhe për bashkëpunimin dypalësh në aktivitete hulumtuese.

Përpjekjet e propozuara nga ky Program Kombëtar i Shkencës duhet të monitorohen me kujdes dhe të vlerësohen së bashku me një procedurë të krahasimit me kritere ndërkombëtare, në mënyrë që të ndërtojmë kapacitete, të mësojmë nga praktikat më të mira dhe të kemi prova të mjaftueshme për të marrë vendime adekuate për të drejtuar zhvillimet, të paktën në aspektin e alokimeve të buxhetit. Duhet kërkuar mundësi për konsulencë ndërkombëtare dhe bashkëpunim ndërkombëtar me qëllim të fillimit të integritit në rrjetet e themeluara ndërkombëtare.

3. Objektivi politik, qëllimi dhe synimet

Ekonomia evolutive në përgjithësi dhe ekonomia inovative në veçanti kanë dhënë prova se zhvillimi i shoqërisë dhe ekonomisë së saj varen, në masë të madhe, nga kapaciteti për të përthithur dhe për të prodhuar dituri të reja, të cilat mund të menaxhohen dhe të transformohen për të kënaqur nevojat kognitive dhe teknologjike të ekonomisë, të shoqërisë dhe të faktorëve socialë (ndërmarrjet, organizatat joqeveritare, ofruesit e shërbimeve shoqërore, organizatat publike dhe publiku si të tillë). Kontributi i teknologjive dhe metodave të reja, si dhe i formave të reja të organizimit shoqëror, për mirëqenien ekonomike të popujve është i padiskutueshëm. Që nga revolucioni industrial, po thuaj se asnjë autor me ndikim nuk ka vënë në pikëpyetje rëndësinë e ndryshimeve teknologjike (Martin dhe Nightingale, 2000). Qasja tek njohuritë shkencore dhe teknologjike jo vetëm që është konsideruar një faktor i rëndësishëm i vendit për tërheqjen e industrive dhe shërbimeve të reja nga jashtë dhe për kujdesin ndaj atyre vendore, por, në fakt, kjo është vijë ndarëse midis “ka” dhe “nuk ka”

Megjithatë, njohuritë dhe teknologjitë nuk mund të transferohen, thjeshtë, nga një vend në një tjetër. Edhe nëse dituria do të ishte e kodifikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse (p.sh. në librat shkencorë, në dokumente dhe në makineri), pa dyshim, ka elemente të nënkuptuara dhe “di-si” (know how) nuk implikon medoemos edhe “di-pse” (know why). Kështu, për një transferim të suksesshëm të diturive, kapacitetet përthithëse duhet të sigurohen nga shoqëria. Këto kapacitete përthithëse duhet të trajnohen për të absorbuar dituri dhe teknologji të prodhuara jashtë, duhet të vihen në pozitë për të adoptuar dhe për të përshtatur njohuri të reja dhe teknologji për nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe të ekonomisë kombëtare, si dhe për të zhvilluar atë më tej përmes veprimtarive të veta kërkimore. Për më tepër, kapacitetet absorbuese të afta për të adoptuar, përshtatur, transformuar dhe zhvilluar njohuritë dhe teknologjitë, gjithashtu duhet të kujdesen edhe për të përhapur njohuritë e tyre për të tjerët (p.sh. ndërmarrjet), ose të paktën tek brezi i ri i studiuesve nga shkenca dhe industria. Kjo është arsyeja se pse arsimi i lartë është aq me rëndësi për një shoqëri.

Dija absorbuese dhe kapacitetet teknologjike në Kosovë janë ndjeshëm të kufizuara, si në numër, ashtu edhe në shtrirje dhe në cilësi. Arsye për këtë deficit është mungesa e financimit të aktiviteteve kërkimore dhe të zhvillimit teknologjik (KZhT) për të paktën 20 vjetët e fundit. Pa një financim të mjaftueshëm të KZhT, nuk mund të thuhet se kapacitetet absorbuese të mundshme në ekonomi dhe në komunitetin akademik në Kosovë shfrytëzohen në nivel të kënaqshëm dhe as që janë në gjendje për të përballuar me sukses progresin teknologjik. Pra, funksioni i tyre absorbues është i kufizuar, tashmë, në drejtim të adoptimit, dhe, edhe më shumë, në kuptim të përshtatjes dhe të zhvillimit të mëtejshëm të njohurive dhe të teknologjisë me aktivitetet e veta krijuese dhe shkencore.

Ky Program Kombëtar i Shkencës ka për qëllim të neutralizojë këto deficite duke ofruar një kornizë konceptuale për ngritjen e kapaciteteve shkencore në Kosovë. Prioritetet kombëtare kërkimore janë identifikuar përmes një procesi me pjesëmarrje dhe fondet për KZhT duhet të kanalizohen drejt tyre. Një numër i prioriteteve kombëtare të identifikuara reflektojnë etje të përgjithshme për të zënë hapin në fushën e shkencës dhe të teknologjisë (Sh&T) në Kosovë në disiplina të ndryshme. Për shkak të pozitës së pavolitshme startuese, është dashur të hiqet dorë nga qasja e specializimeve të ngushta në studimin e disa teknologjive bashkëkohore (p.sh. nano-teknologjia). Thjeshtë, mungonte baza e nevojshme për një qasje të tillë. Prioritetet kombëtare të identifikuara janë, megjithatë, mjaft të kuptueshme dhe me synime të qarta për t’i përqendruar përpjekjet dhe për të koncentruar financimin në disa fusha të përzgjedhura të KZhT që konsiderohen të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Përmes kësaj qasjeje mund të sigurohet masa kritike për krijimin e kapaciteteve përthithëse të KZhT për zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës.

Qartazi, sektori kërkimor në vetvete nuk është përfituesi i vetëm i kësaj qasjeje, por edhe fushat e tjera të politikave, si politikat ekonomike, politikat shëndetësore, politikat e mjedisit, politikat bujqësore, planifikimi urban dhe rural, politika e jashtme dhe politika e integritimit evropian, të gjitha këto do të përfitojnë menjëherë nga një bazë e përmirësuar e njohurisë të kapaciteteve kërkimore të Kosovës. Në këtë kuptim, KZhT nuk është një qëllim më vete, por është një lehtësues për bërjen e politikave të bazuara në fakte në shumë sfera të tjera shoqërore, ekonomike dhe ekologjike në Kosovë.

Synimet specifike të shkencës dhe teknologjisë (Sh&T) të cilat janë të nevojshme për të mbështetur zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës drejt një Shoqërie të Dijes në linjë me bashkëveprimin e bazuar në fakte ndërmjet shkencave bazike, qytetarëve dhe të biznesit, janë:

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore- shkencore

Objektivi 2: Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore

Objektivi 4: Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

Objektivi 5: Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore

Është e vetëkuptueshme se pesë objektivat kanë lidhshmëri të madhe me njëri-tjetrin dhe, kështu nuk duhet të trajtohen si të izoluara, por në mënyrë sistematike. Në vazhdim janë prezantuar caqet për secilin objektiv dhe aktivitetet më të nevojshme për arritjen e tyre:

| | |
|--------------------|---|
| Objektivi 1 | Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore-shkencore |
| Caqet | <p>1.1. Nxitet zhvillimi i programeve të doktoratës në institucionet e arsimit të lartë.</p> <p>1.2. Deri në vitin 2015 të paktën 50 kandidatë do të marrin mbështetje për të ndjekur studimet e pasdoktoratës nëpërmjet programeve të përbashkëta me financim të plotë ose të pjesshëm nga Buxheti i Kosovës.</p> <p>1.3. Deri në vitin 2015 të paktën 100 kandidatë nga Kosova do të ndjekin studimet e doktoratës në ndonjë nga 500 universitetet më të mira të botës me financim të plotë ose të pjesshëm nga Buxheti i Kosovës.</p> <p>1.4. 100 bursa afat-shkurtra mobiliteti për hulumtuesit aktivë.</p> |
| Veprimi | <p>1.1. Zhvillohen programe të doktoratës të cilësisë së lartë në Kosovë, mundësisht në bashkëpunim me institucione të afirmuara të arsimit të lartë dhe të shkencës nga vende të tjera. Programet që përfundojnë me dhënien e thirrjes së dyfishtë do të kenë prioritet absolut. Në parim, edhe programet ekzistuese të doktoratës do të mund të përfitojnë nga kjo mundësi.</p> <p>1.2. Lehtësohet pjesëmarrja në programet pasdoktorale në qendrat e përsosmërisë në të gjithë botën. Preference duhet t'u jepet kandidatëve që synojnë të kryejnë kërkime që çojnë në publikime në revista të referuara ndërkombëtare.</p> <p>1.3. Përkrahet përfundimi i studimeve të doktoratës në fushat prioritare ose në fushat ku ka mungesë të studiuesve kosovarë në universitetet prestigjioze të botës. Mbështetja duhet të synojë të rinjtë që janë të përkushtuar për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve</p> |

| | |
|--------------------|---|
| | <p>hulumtuese në Kosovë.</p> <p>1.4. Ofrohet mbështetje për mobilitet afatshkurtër të hulumtuesve kosovarë në institucionet e vendeve të tjera. Një lëvizje e tillë duhet të çojë në botime dhe /ose krijimin dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm midis institucionit vendës dhe atij mikpritës.</p> |
| Objektivi 2 | Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore- shkencore |
| Caqet | <p>2.1. Deri në vitin 2012 rishikohet dhe freskohet infrastruktura ligjore (korniza).</p> <p>2.2. Sigurohen laboratorë dhe pajisje që përmbushin nevojat optimale të hulumtuesve me mbështetje të plotë ose të pjesshme nga Buxheti i Kosovës. Synohet që deri në vitin 2015 të bëhet themelimi i të paktën 10 laboratorëve (secili me vlerë më shumë se 250,000 €) që duhet të jenë të akredituar, dhe, përveç kësaj, ndarja e pajisjeve shkencore shtesë në një shumë totale prej 1 mil € në rrugë institucionale bazuar në ftesa të hapura dhe konkurruese për propozime.</p> <p>2,3. Deri në vitin 2012 ndërtohet Sistemi Informativ i KZhT.</p> <p>2.4. Deri në vitin 2011 sigurohet qasja në bibliotekat elektronike relevante.</p> |
| Veprimi | <p>2.1 Rishikohet Ligji aktual për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe bëhen përshtatje të nevojshme për të përmbushur nevojat e shoqërisë dhe për të përafuar legjislacionin me atë që zbatohet në vendet e BE-së. Gjithashtu, është me rëndësi të zhvillohen akte nënligjore për trajtimin e çështjeve të qasjes në fonde qeveritare për hulumtim. Duhet të rishikohen edhe ligjet fiskale për të shqyrtuar mundësinë e aplikimit të preferencave tatimore për aktivitete kërkimore.</p> <p>2.2. Krijohet Programi Kombëtar i Infrastrukturës Kërkimore për të kanalizuar financimin qeveritar për laboratorët dhe pajisjet për kërkime shkencore në bazë të nevojave të arsyeshme dhe prioriteteve kombëtare të shkencës. Në financim duhet të kenë qasje të gjitha institucionet kërkimore nga Kosova që demonstrojnë potencial për zhvillimin e programeve të qëndrueshme kërkimore. Një përparësi e veçantë do t'u jepet laboratorëve ndërdisiplinorë, ndërkohë që do të inkurajohet ndërlidhja e Programit të Infrastrukturës me programet e doktoratës që përkrahen nga fondet për shkencë.</p> <p>2.3. Zhvillohet sistemi informativ KZhT. Hapi i parë është emërimi i grupit ndërdisiplinor të eksperteve për të zhvilluar termat e referencës për sistemin, përfshirë llojin e informatave të nevojshme, fleksibilitetin, politikën gjuhësore, etj Ky aktivitet duhet të bashkërenditet me Entin e Statistikës të Kosovës.</p> <p>2.4. Sigurohet/blidhet qasja në biblioteka elektronike relevante pas analizës së nevojave që përfshin të gjitha institucionet relevante në Kosovë. Pritet që edhe institucionet përfituese të kontribuojnë në mbulimin e shpenzimeve.</p> |
| Objektivi 3 | Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore |
| Caqet | 3.1. Mbështetje për botimin e një numri të konsiderueshëm të |

| | |
|----------------|---|
| | <p>publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare.</p> <p>3.2. Vlera e përgjithshme vjetore e projekteve të përbashkëta kërkimore me institucionet e huaja është të paktën 2 milion euro duke filluar me vitin 2012.</p> <p>3.3. Pjesëmarrje e zgjeruar në rrjetet ndërkombëtare hulumtuese</p> <p>3.4. Bashkëpunim i përmirësuar me studiuesit tanë që punojnë jashtë.</p> |
| Veprimi | <p>3.1. Krijohet Programi për Mbështetjen e Publikimeve si burim financimi për mbulimin e shpenzimeve për shkencëtarët kosovarë për botim në revista ndërkombëtare. Financimi duhet të vihet në dispozicion në baza konkurruese dhe duke siguruar transparencë të plotë.</p> <p>3.2. Ofrohet mbështetje për zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe një bashkëfinancim për zbatimin e tyre. Në këtë mënyrë, Qeveria do të inkurajojë pjesëmarrjen e institucioneve të Kosovës në projektet kërkimore ndërkombëtare, kryesisht bazuar në marrëveshjet ndërqeveritare për Sh & T dhe skema të tjera bi - dhe multilaterale.</p> <p>3.3. Ofrohet mbështetje për pjesëmarrje në rrjete kërkimore shkencore ndërkombëtare, sidomos në Programin Evropian Kornizë për KZhT dhe COST. Hulumtuesit dhe institucionet nga Kosova do të zhvillojnë bashkëpunim me homonimet nga vendet e tjera.</p> <p>3.4. Zhvillohet Programi “Kthimi i trurit”. Do të krijohet një fond i posaçëm që të jetë në dispozicion të institucioneve të Kosovës për të pritur hulumtuesit nga Kosova që jetojnë në vende të tjera.</p> |

| | |
|--------------------|---|
| Objektivi 4 | Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror |
| Caqet | <p>4.1. Krijimi i një programi të zbatueshëm të kërkimit shkencor dhe të zhvillimit teknologjik për të mbështetur raportet shkencë-industri me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve bashkëpunuese teknologjike deri në vitin 2013, i cili do të zbatohet me fond të mjaftueshëm në vitin 2014.</p> <p>4.2. Krijimi i një programi për inovacione për të përmbushur nevojat e inovacionit ekonomik dhe social të sektorit privat (biznesit, OJQ) deri në vitin 2015, i cili do të zbatohet me fond të mjaftueshëm në vitin 2016.</p> |
| Veprimi | <p>4.1. Themelohet një grup pune në vitin 2012 me përfaqësues nga shkenca dhe biznesi për të përgatitur deri në vitin 2013 rregullat dhe rregulloret e një programi sistematik të aplikuar në KZhT, të orientuar drejt transferit të teknologjisë në mes shkencës dhe industrisë dhe krijimin e grupacioneve (që përfshijnë të dyja, shkencën dhe të biznesin).</p> <p>4.2. Publikohen ftesat e para për propozime konkurruese brenda këtij programi të aplikuar të KZhT në vitin 2014.</p> <p>4.3. Krijohet një grup pune në vitin 2014 i përbërë nga përfaqësues të shkencës, të biznesit dhe të shoqërisë civile, me detyrë që, deri në vitin 2015, të përgatisë rregullat dhe rregulloret për një program të inovacioneve</p> |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| | |
|--------------------|---|
| | <p>të orientuar drejt nevojave për risi teknologjike, organizative dhe sociale të sektorit privat (biznesi, OJQ-të). Ky program duhet, në radhë të parë, të synojë NVM-të, industrinë e madhe, sektorin social dhe sektorin shërbyes.</p> <p>4.4. Bëhen të gjitha përgatitjet për të publikuar konkursin e parë për propozime sipas këtij programi inovativ në vitin 2016.</p> |
| Objektivi 5 | Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore |
| Caqet | <p>5.1. Themelimi i qendrave të përsosmërisë shkencore,</p> <p>5.2. Mbështetja e disiplinave fundamentale,</p> <p>5.3. Zbatimi i çmimeve për arritje të jashtëzakonshme,</p> <p>5.4. Institucionet kërkimore-shkencore ndërtojnë mekanizma të sigurimit të cilësisë në fushën e kërkimit shkencor.</p> |
| Veprimi | <p>5.1. Themelohen qendra të përsosmërisë shkencore bazuar në kapacitetet kërkimore ekzistuese dhe prioritetet kombëtare të shkencës. Duhet përfshirë edhe ekspertët me origjinë kosovare. Synohet që në të ardhmen të themelohen pesë qendra të përsosmërisë në fushat e orientuara nga e ardhmja (p.sh. teknologjitë bashkëkohore, hulumtimet biomjekësore, etj.), edhe atë ndërmjet viteve 2013 dhe 2014.</p> <p>5.2. Hartimi i rregullave dhe rregulloreve dhe financimi i disiplinave fundamentale. Duhet definuar përpjesëtimin minimal të fondit në dispozicion për kërkime shkencore në disiplinat fundamentale. Deri në vitin 2015, duhet rezervuar fonde të dedikuara për funksionimin e një programi konkurrues për kërkime fundamentale.</p> <p>5.3. Themelohet fondi për çmime vjetore për arritje të jashtëzakonshme në promovimin e përsosmërisë shkencore deri në 2011. Çmimet duhet të jepen për "studiuesit kosovarë të vitit" dhe "studiuesit më të mirë të rinj të vitit në Kosovë".</p> <p>5.4. Zhvillimi i mekanizmave të sigurimit të cilësisë në fushën e kërkimit shkencor, si doracakëve për indeksimin e botimeve, etj</p> |

4. Caktimi i prioriteteve të kërkimit shkencor e të zhvillimit në Kosovë

4.1. Arsyeshmëria e vendosjes së prioriteteve

Arsyeja për të identifikuar dhe vendosur prioritetet në kërkime shkencore dhe në teknologji në Kosovë është që të kanalizohen fondet e pakta në ato fusha të cilat janë më të përshtatshme për zhvillimin e mëtejshëm shoqëror dhe rritjen ekonomike të Republikës së Kosovës. Po të mos caktohen prioritetet, atëherë mjetet e kufizuara financiare në dispozicion do të shpërndaheshin nëpër shumë disiplina, nën-fusha dhe tema. Ato, thjeshtë, do të zhdukeshin pa kontribuar në krijimin e një mase kritike për të zhvilluar kapacitetet absorbuese të KZHT në Kosovë.


Historia e 50 vjetëve të fundit në vendosjen e prioriteteve në shkencë dhe në teknologji tregon për deri katër modele të ndryshme, të cilat (sipas Gassler et al, 2006) janë:

- 1) Orientimi 'klasik' nga misioni me origjinë në ndërmarrjet e 'shkencës së madhe' pas Luftës së Dytë Botërore;
- 2) Qasja e 'teknologjive kyçe civile';
- 3) Qasjet e orientuara tek 'sistemi'; dhe
- 4) Qasja e prioriteteve 'tematike' krahas problemeve socio-ekonomike.

Përderisa forca paradigmatiche e qasjes së katërt, që është më e reja, është ende duke u diskutuar, zhvillimi i modeleve më të vjetra tregon se prioritetet që janë identifikuar më parë me një model më të vjetër, nuk janë shkëmbyer thjeshtë nga prioritetet e reja të zhvilluara sipas modelit të ri, por i janë shtuar të mëparshmeve (shih Fig. 1).

Fig. 1: Rrjedhat e caktimit të prioriteteve në shkencë dhe teknologji

Qëllimi dhe lloji aktivitetëve të politikave publike të KZHT



Burimi: Gassler, Polt, Rammer (2006)

Modeli klasik për caktimin e prioriteteve në Sh & T duke u orientuar nga misioni nuk është relevant për Kosovën. Ky është vënë në një nivel me "shkencat e mëdha", duke u përqendruar në teknologjitë relevante për luftë (p.sh. teknologjitë atomike, shkencat materiale, teknologjitë ajrore dhe hapësinore). Kjo ishte fillimisht një shtyrje shkencore, qasje e bazuar në nevojat e publikut që kërkonte një sistem shumë të centralizuar të qeverisjes në sistemin shkencor me ndarje të përshtatshme buxhetore. Në ShBA ende i kushtohet rendësi e madhe, ndërsa në një masë më të vogël edhe në Francë e në Mbretërinë e Bashkuar.

Qasja e 'teknologjive kyçe civile' fokusohet në teknologjitë me potenciale të mëdha të aplikimit komercial. Kjo legjitimohet me argumentin e dështimit të tregut dhe shpesh nxitet nga politikat e "kompensimit". Në përgjithësi, prioritetet në Sh&T me potencialin më të madh aplikativ thuhet të jenë: teknologjitë e informimit e të komunikimit (TIK), teknologjitë prodhuese, bioteknologjia, teknologjia e mjedisit, materialet, energjia, pajisjet mjekësore dhe nano-teknologjia. Sidomos në vendet në zhvillim, ato plotësohen nga prioritetet më të vjetra teknologjike (p.sh. në fushën agro-ushqimore, në gjeologji, në vaksinim etj). Koncepti i "teknologjive kyçe" civile duket të jetë shumë relevant për Kosovën, megjithëse ka disa kufizime për një shfrytëzim të plotë.

- Së pari, baza teknologjike dhe shkencore është shumë e kufizuar në një numër të prioriteteve premtuese të Sh&T (p.sh. nano-teknologjia, bioteknologjia), që e bën pothuajse të pamundur për të filluar një strategji të zënies së hapit, pa investuar shuma të mëdha parash në këto prioritete.
- Së dyti, prioritetet e mbetura kombëtare zakonisht zbatohen në programet e caktuara të Kërkimit dhe të Zhvillimit Teknologjik. Deri më tani, në Kosovë ekziston një përvojë shumë e kufizuar për krijimin dhe zbatimin e programeve të Kërkimit dhe Zhvillimit Teknologjik në formë të organizuar, të paanshme dhe transparente. Kështu, duhet të krijohen urgjentisht kapacitetet për menaxhimin e programeve të KZhT-së!
- Së treti, duhet të sigurohet një përfshirje e palëve më të rëndësishme (jo vetëm nga shkenca por edhe nga industria dhe sektori social) në programimin e KZhT qëllim të kanalizimit të financave në sektorët me potencialin më të lartë për të qenë efektiv. Megjithatë, pjesëmarrja e grupeve të interesit mund të çojë tek një trajtim preferencial (kur nuk përzgjidhen teknologjitë kyçe dhe më premtuese, ose përzgjidhen grupet më të zëshme lobuese).
- E katërta, koncepti "teknologjia kyçe" është i orientuar kryesisht nga industria dhe zbatimi. Kështu, kapacitetet përthithëse në industri dhe në sektorin social duhet të zhvillohen në të njëjtën kohë.
- Një përcaktim tepër i ngushtë i teknologjive kyçe dhe i prioriteteve të Sh&T mund të çojë në varësi nga shtegu (në bllokim) dhe të shtrembërojë konkurrencën ndërmjet teknologjive alternative. Përkufizimi i prioriteteve të Sh&T në konceptin e tanishëm, megjithatë, ka marrë parasysh këtë rrezik dhe ka vendosur të mos përcaktojë prioritete tepër të ngushta.

Edhe pse, koncepti i "teknologjive kyçe civile" është relevant për Kosovën, dhe pikërisht për këtë edhe pjesërisht vendimtar për këtë Program Kombëtar të Shkencës, ky prapëseprapë duhet të përplotësohet nga një "qasje e orientuar nga sistemi". Kjo "qasje e orientuar nga sistemi" fokusohet në prioritetet funksionale (p.sh. mbështetje për avancimin e marrëdhënieve shkencë-industri dhe për transferin e teknologjisë, ndikim i financimit privat, krijimi i skemave të kualifikimit shkencor, qasje në programet ndërkombëtare të KZhT-së; qasje në dijet e huaja, etj). Kjo qasje është legjitimuar nga argumenti i dështimit të sistemit të KZhTI (domethënë tejkalmimi i fragmentimit të sistemit inovativ), i cili është shumë relevant në Kosovë. Dhe është i motivuar nga një kuptim bashkëkohor i sistemit inovativ me një theks në

bashkëpunimin vertikal dhe horizontal, i cili duhet të mbështetet nga korniza të favorshme për inovacionet (tatimet, ligjet e punës, politikat rajonale e të tjera).

Përkundër rëndësisë së kësaj "qasjeje të orientuar nga sistemi" për Kosovën, ka ende disa mangësi institucionale që duhet të zgjidhen në mënyrë që të këtë shfrytëzim të plotë të saj.

- Së pari, ky koncept zakonisht zbatohet përmes programeve të specializuara dhe të decentralizuara të Kërkimit dhe Zhvillimit Teknologjik. Siç u përmend më lart, duhet të krijohen urgjentisht kapacitetet e menaxhimit të programeve të KZhT në Kosovë për të garantuar implementim efikas, efektiv dhe transparent të programeve dhe alokimin e tyre financiar.
- Së dyti, "qasja e orientuar nga sistemi" përqendrohet në përmirësimin e lidhjeve midis shkencës e industrisë. Në rastin e Kosovës, sidoqoftë, jo vetëm që duhet përmirësuar lidhjet, por edhe nën-sistemet (p.sh. sektori universitar, sektori i NVM-ve, politikat tatimore etj) kanë nevojë për një përmirësim substancial. Prandaj, fokusi i këtij Programi Kombëtar të Shkencës është në ngritjen e kapaciteteve shkencore gjatë 3-4 vjetëve të para, para fillimit të nxitjes së lidhjeve me industrinë dhe me sektorin social (duke filluar nga viti 2014).

Së fundi, edhe elemente të të ashtuquajturës "paradigmë e re e orientuar kah misioni", e cila në mënyrë eksplicite përqendrohet në problemet socio-ekonomike, janë marrë parasysh në mënyrë të qartë në këtë dokument koncept. Në mënyrë të veçantë, kjo paradigmë e re në zhvillim fokusohet në problemet, të cilat, kryesisht, bien nën kompetencën e fushave të ndërlidhura politike, siç janë mjedisi dhe shëndetësia. Në këtë Program Kombëtar të Shkencës, theks i veçantë vihet në mjedis, shëndetësi, strukturë ekonomike të vendit dhe në mbështetjen e kërkimit të paanshëm shkencor të përqendruar në çështjen e identitetit kombëtar në një botë që po kalon në procese të globalizimit. Financimi për Kërkim dhe Zhvillim Teknologjik është i motivuar kryesisht për të zgjidhur problemet dhe jo për shkak të rrezikut teknologjik. Inovacionet në rritje, përshtatja dhe shtrirja e teknologjisë, dhe orientimi nga përdoruesi janë në qendër të kësaj qasjeje, e cila e përplotëson arsyeshmërinë e vendosjes së prioritetëve të SH&T në Kosovë.

4.2. Procesi i vendosjes së prioritetëve

Procesi i vendosjes së prioritetëve në Sh&T është legjitimuar nga Ligji për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, ku në nenin 51 parashihet që Programi Kombëtar i Shkencës duhet t'u kushtojë vëmendje:

- fushave të caktuara shkencore që duhet të zhvillohen në mënyrë të veçantë (neni 51, a dhe b)
- zhvillimeve në veprimtarinë kërkimore-shkencore (neni. 51, c);
- avancimeve në investimet e entiteteve juridike kërkimore-shkencore (neni 51, d);
- programit të pjesëmarrjes në projekte kërkimore-shkencore ndërkombëtare (neni 51, e);
- programit të blerjes dhe të shfrytëzimit të pajisjeve (neni 51, f);
- programit të arsimit sistematik të punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve (neni 51, g);
- programit të zhvillimit të informacionit shkencor dhe të publikimit të rezultateve të arritura të punës kërkimore - shkencore (neni 51, h);
- mjeteve të nevojshme për realizimin e Programit Kombëtar Shkencor (neni 51, i).

Të gjitha këto fusha janë marrë parasysh tashmë në Programin Kombëtar të Shkencës, i cili - përsëri sipas ligjit – duhet të miratohet për një periudhë pesëvjeçare (neni 52,2).

Neni 54 i Ligjit parasheh shprehimisht që Këshilli Kombëtar i Shkencës i paraqet Qeverisë së Kosovës propozimin e Programit Kombëtar të Shkencës. Kështu, Këshilli Kombëtar i Shkencës synoi që të përmbushë detyrimin e vet ligjor dhe filloi procesin për të përmbushur obligimin ligjor. Asistenca për këtë proces është dhënë nga projekti austriak- KAIP. Takimi i parë i KKSH me ekspertët në Austri është mbajtur në dhjetor të vitit 2008 në Vjenë. Pas kësaj, është përgatitur dokumenti i parë i procesit i cili më pas është rafinuar.

Në mënyrë që të sigurohet një qasje pjesëmarrëse, janë organizuar dy takime pune nga dy ditë me një numër të madh të përfaqësuesve të sektorit shkencor. Takimi i parë i punës u mbajt në Mavrovë, në shtator të vitit 2009, kurse i dyti në nëntor të vitit 2009 në Selanik. Gjithashtu ka pasur punëtori më të vogla konsultuese në mes dhe pas këtyre dy punëtorive. Lista e kontribuuesve në procesin e hartimit të këtij dokumenti është dhënë në shtojcën 1.

Drafti i Programit Kombëtar të Shkencës është aprovuar nga KKSH më 11 shkurt 2010 dhe është lëshuar në diskutim publik. Më 3 mars 2010 është mbajtur në Prishtinë konferenca kombëtare që ka pasur për qëllim diskutimin e draftit të Programit, ku kanë marrë pjesë mbi 100 punonjës shkencorë nga Kosova. Vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna gjatë diskutimit publik kanë pasur ndikim domethënës në formësimin përfundimtar të Programit.

4.3. Instrumentet e mundshme për përdorim në Politikat e Sh & T

Në kohën e sotme të politikave të shumta mund të vërehet begatia e qasjeve dhe instrumenteve të ndryshme për të realizuar objektivat e politikave bashkëkohore të shkencës dhe teknologjisë dhe për të realizuar një sistem funksional të kërkimit shkencor dhe të inovacionit. Kjo larmi është zhvilluar në harmoni me paradigmat e prioriteteve të shkencës e të teknologjisë të theksuara në seksionin 4.1. Për këtë Program Kombëtar të Shkencës janë me rëndësi një numër i qasjeve dhe i instrumenteve që mund t'u atribuohen standardeve ndërkombëtare në hartimin e politikave bashkëkohore në shkencë dhe teknologji. Një karakteristikë e përbashkët është shpërndarja konkurruese e fondeve në dispozicion nëpërmjet konkurseve për propozime, të cilat vlerësohen ose drejtpërdrejt nga komuniteti shkencor (rishikim i kolegut) ose nga grupe të pavarura ekspertesh (rishikimet e eksperteve). Procedura e tenderimit zakonisht zbatohet nga një organ i ndarë në mënyrë funksionale nga ministria (p.sh. "Fondacioni Kombëtar i Shkencës", "Agjencia për Promovimin e Kërkimeve Shkencore", "Fondi për Promovimin e Kërkimeve Shkencore" etj), i cili megjithatë i përgjigjet ministrisë përkatëse të ngarkuar me shkencën dhe teknologjinë. Shpesh këto operacione janë paraparë në një ligj të veçantë për financimin e kërkimeve shkencore, i cili përcakton parimet kryesore udhëzuese dhe rregullat institucionale. Në këtë kuptim, rekomandohet freskimi i ligjit ekzistues për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe/ose plotësimi i tij me një ligj të veçantë ose rregullore për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, i cili do të parashihte më në hollësi zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës.

Në mesin e instrumenteve kryesore të cilat do të përdoren për implementimin operacional të këtij programi Kombëtar të Shkencës janë:

- 1) Programet e doktoratës për edukimin e shkencëtarëve të rinj në mjedise të dalluara institucionale (p.sh. brenda programeve të përbashkëta ndërkombëtare që çojnë në diploma të dyfishta ose në qendra të veçanta të përsosmërisë në universitete).
- 2) Bursa individuale për studime pasdoktorale për promovimin e karrierës shkencore në fushat prioritare, si në vend ashtu dhe jashtë vendit.

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

- 3) Bursa individuale të hulumtuesve për doktoratë për promovimin e karrierës shkencore në fushat prioritare në vend dhe jashtë.
- 4) Bursa për mobilitet afatshkurtër për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis institucioneve vendore dhe mikpritëse për bashkëpunim në avancimin e shkencave.
- 5) Financim konkurrues i rrjeteve të infrastrukturës kërkimore-shkencore dhe laboratorëve qendrorë kombëtarë në fushat prioritare shkencore.
- 6) Financimi i projekteve të pavarura për pajisje, përmes procesit të prokurimit bazuar në planet zhvillimore dhe në procedura konkurruese të tenderimit
- 7) Blerja ose zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi informativ të KZhT-së, i cili gjithashtu shërben edhe për sigurimin e statistikave për shkencën e teknologjinë në shkallë kombëtare.
- 8) Sigurimi i qasjes për hulumtuesit kosovarë në bibliotekat përkatëse elektronike (p.sh. Thomson Web of Knowledge; SCOPUS etj).
- 9) Krijimi i fondeve për të mbështetur botimet shkencore dhe komunikimet shkencore (p.sh. për publikimet e pavarura si monografitë; përkthimin e publikimeve të pavarura; për të trajtuar dimensionin ndërkombëtar duhet dhënë prioritet për publikim në revista ndërkombëtare)
- 10) Sigurimi i bursave konkurruese për projekte të përbashkëta me një institucion partner të huaj të financuara nga programet bilaterale ndërqeveritare të KZhT-së, të nënshkruara midis Kosovës dhe vendeve të tjera apo nga skema të karakterit një-dy apo më shumë palëshe.
- 11) Shpërndarje konkurruese të bursave për përgatitjen e projekteve për të aplikuar në kuadër të një konsorciumi ndërkombëtar për financim evropian nën COST dhe sidomos të Programit Kornizë Evropian të KZhT.
- 12) Themelimi i një fondi për “kthimin e trurit” për të tërhequr hulumtuesit e huaj e sidomos hulumtuesit kosovarë që punojnë jashtë vendit.
- 13) Implementimi i një programi të aplikuar konkurrues të KZhT për të shmangur vështirësitë në relacionin shkencë-ekonomi. Projektet individuale të aplikuara të KZhT-së, përfshijnë një komponentë të fortë të transferit të teknologjisë e të dijes. KZhT duhet të pasqyrojë qartë nevojat ekonomike. Edhe pse hulumtimi (kryesisht) kryhet nga organizatat publike kërkimore-shkencore, përfituesit duhet të gjenden në sektorin e biznesit .
- 14) Themelimi i një programi inovativ të orientuar drejt nevojave të inovacionit teknologjik, organizativ dhe shoqëror të sektorit privat (biznesit, OJQ-ve). Implementimi është i bazuar në financimin konkurrues të projekteve bashkëpunuese individuale (duke përfshirë në mënyrë aktive partnerët nga bizneset, nga shoqëria dhe nga radhët e komunitetit akademik), për të gjeneruar zbatime të reja konkrete ekonomike, shoqërore apo kulturore.
- 15) Financimi konkurrues i pesë qendrave kombëtare të përsosmërisë në fusha prioritare kërkimore shkencore (sidomos në teknologjitë e reja) bazuar mbi programe të shëndosha individuale të KZhT-së, mbi aktivitete transparente, realiste dhe favorizuese në terren, dhe në detyra të avancuara arsimore dhe përfshirje ndërkombëtare.
- 16) Themelimi i një fondi konkurrues për kërkime fundamentale të hapur për të gjitha disiplinat shkencore.
- 17) Zbatimi i shpërblimeve vjetore individuale për punëtorët më të shquar të Kosovës dhe për hulumtuesit e rinj.

18) Zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë e të vlerësimit të fokusuar në aktivitete kërkimore-shkencore, duke përfshirë edhe masat paraprake, vlerësimin e institucionit, të programit dhe të politikave (përfshirë caktimin e standardeve krahasuese për organizatat kërkimore shkencore dhe institucionet për hartimin e politikave).

Instrumentet 1-4 i referohen objektivit 1 ("Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për aktivitete kërkimore shkencore) të këtij Programi Kombëtar të Shkencës në Kosovë.

Instrumentet 5-8 i referohen objektivit 2 ("Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore").

Instrumentet 9-12 i referohen objektivit 3 ("Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore").

Instrumentet 13 e 14 i referohen objektivit 4 ("Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror").

Instrumentet 15-18 më në fund i referohen objektivit 5 ("Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore") të këtij Programi Kombëtar të Shkencës në Kosovë.

Ndonëse numri prej 18 instrumenteve të ndryshme zbatuese për financimin e kërkimeve shkencore në Kosovë mund të duket i madh në shikim të parë, instrumentet e propozuara konsiderohen të nevojshme për të përmbushur jo vetëm kërkesat e përcaktuara me ligj, por edhe për të përgatitur terrenin për një zhvillim të plotë dhe të planifikuar të sistemit të kërkimeve shkencore e të inovacionit në Kosovë. Shumica e instrumenteve të propozuara kanë ngjashmëri nga aspekti logjistik dhe operacional. Kështu, mund të pritët bashkëpunim i madh në zbatimin dhe nxënien e shpejtë të procedurave dhe instrumenteve. Sidoqoftë, rekomandohet fuqishëm fillimi i menjëhershëm i krijimit të kapaciteteve profesionale në menaxhimin e programeve kërkimore e shkencore, ndërmarrja e masave paraprake institucionale dhe hartimi i rregullave e rregulloreve për të shndërruar objektivat e përcaktuar në Programin Kombëtar të Shkencës në aktivitete operationale duke u bazuar në parimin e qeverisjes së mirë dhe menaxhimit modern publik dhe administrativ.

Instrumentet kryesore të cilët nuk janë trajtuar në fazën e parë të zbatimit të këtij Programi Kombëtar të Shkencës, mirëpo, të cilat zakonisht zbatohen në sisteme të avancuara inovative janë:

- Programe, të ashtuquajtura, strukturore, për të shmangur problemet strukturore dhe vështirësitë nëpërmjet projekteve bashkëpunuese (shkencë-industri). Skemat e tilla mund të përqendrohen në themelimin e programeve fillestare për personelin akademik, në mbështetje infrastrukturore për qendra të transferit të teknologjisë dhe të inovacionit, duke rritur interesin për kërkime shkencore teknologjike në mesin e të rinjve, etj. Për më tepër, programet inovative të lidhura me NVM-të ose me industrinë e mëdha mund të avancohen edhe më tutje (p.sh. thithja e investimeve të huaja në KZhTI; zbatimi i masave të tërthorta, si regjimi tatimor miqësor ndaj inovacioneve, etj). Kjo, megjithatë, më shpesh është bërë nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, se sa nga Ministria e Shkencës.
- Programe të synuara tematike për të krijuar masë kritike në fushat që janë të rëndësishme strategjike për zhvillimin ekonomik dhe teknologjik. Tema të tilla mund të jenë teknologjitë e përgjithshme me potenciale të gjera të zbatimit (siç janë rrjetet elektronike, ambienti që ndihmon jetesën, nano-programet, programet e kërkimit gjenetik etj) apo ato me kapacitete absorbuese industriale (siç janë; sistemet inteligjente të transportimit në vende me industri të zhvilluar automobilistike). Sidoqoftë, kjo situatë nuk është (akoma) e pranishme në Kosovë. Megjithëse prioritetet e këtij Programi Kombëtar të Shkencës janë të definuara nga aspekti tematik, nuk rekomandohet institucionalizimi i programeve të

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

veçanta të caktuara për këto tema, por më parë të adresohen ato me shtrirje më të gjerë të instrumenteve të cilat janë relevante për të gjitha këto tema (siç është treguar me lart).

5. Zhvillimi i pesë plus një prioritetëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës në Kosovë

5.1. Parathënie

Në dy dekadat e fundit Kosovës i ka munguar një sistem i mirëfilltë shkencor, kështu që ekziston nevojë e madhe për të ringjallur veprimtarinë kërkimore shkencore në pothuaj se të gjitha disiplinat. Nga ana tjetër, është e rëndësishme për shkencën që të kontribuojë për zhvillimin e vendit dhe për të lehtësuar integrimin e tij në Shoqërinë e Dijes. Do të kishte qenë shumë më e lehtë të bëhej identifikimi i prioritetëve kombëtarë duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit Kombëtar, por realiteti është se Kosova nuk e ka një dokument të tillë. Prandaj, Ekupi Planifikues ka rënë dakord për gjashtë kritere për caktimin e prioritetëve:

- Rëndësia për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit,
- Numri dhe cilësia e burimeve njerëzore në vend dhe në diasporë,
- Kushtet e infrastrukturës kërkimore shkencore,
- Kontributi për ruajtjen dhe promovimin e identitetit kombëtar të Kosovës,
- Ekzistimi i potencialit për arritjen e rezultateve kërkimore-shkencore dhe zbatimin e tyre brenda dhe jashtë
- Ekzistimi i bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e caktuar.

Janë analizuar gjashtë fusha të shkencës dhe teknologjisë sipas Manualit të Frascatit²:

- 1) Shkencat e natyrore
- 2) Inxhinieria dhe teknologjia
- 3) Shkencat mjekësore
- 4) Shkencat bujqësore
- 5) Shkencat shoqërore
- 6) Shkencat humane

Fillimisht, janë analizuar 33 disiplina dhe është hartuar një listë prej 16 prioritetëve të mundshme kërkimore. Diskutimet vijuese rezultuan me caktimin e pesë prioritetëve të mëposhtme:

1. Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi
2. Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit.
3. Kërkimet shkencore në mjekësi
4. Studimet shoqërore dhe ekonomike
5. Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike.

Përveç kësaj, fusha e Teknologjisë Informativë dhe Komunikuese konsiderohet si prioritet ndër-horizontal që mund të shfaqet në cilëndo nga fushat e lartpërmendura.

Pozicioni i Këshillit Kombëtar të Shkencës është se disiplinat që nuk janë radhitur në këto fusha prioritare, duhet të përfitojnë nga fondi i programeve kërkimore-shkencore të funksionalizuara nga Qeveria, duke trimëruar aktivitetin kërkimor-shkencor në këto fusha. Sidoqoftë, fushat prioritare duhet të marrin mbështetje shtesë nga Qeveria, sektori publik dhe

² Manuali i Frascatit – Praktikë standarde të propozuara për anketa për hulumtime dhe zhvillim eksperimental, OECD, 2002

privat në vend, ngase kërkimi-shkencor në këto fusha e ndihmon drejtpërdrejtë zhvillimin e vendit.

5.2. Prioriteti 1: Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi

5.2.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Për momentin, Kosova është duke u përballur me një numër problemesh sa i përket mjedisit, energjisë dhe burimeve natyrore, të akumuluarra për dekada të tëra si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar të burimeve natyrore dhe minerale, dendësisë së madhe të popullatës, dhe pranisë së aktiviteteve ekonomike me ndikim të madh mjedisor, si: bujqësia, prodhimi i energjisë elektrike dhe xehetaria, si dhe vendbanimet urbane të shoqëruara me shkallë të lartë të ndotjes. Sot në Kosovë përdoret në veçanti dueti i karburanteve fosile të thëngjillit dhe naftës nga të cilat sigurohet gati e gjithë energjia. Për shkak të mungesës së hulumtimeve në shkallë vendi ende nuk ka ndonjë shqetësim të dukshëm për pasojat negative mjedisore dhe sociale të përdorimit të këtyre fosileve, siç janë ndotja e ajrit, tokës dhe ujit. Prandaj, aktiviteti kërkimor-shkencor në fushat që lidhen me ndryshimet klimatike, me ndotjen dhe me rreziqet, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe teknologjinë mjedisore është një domosdoshmëri për të siguruar një cilësi më të mirë të jetës, mjedis të pastër dhe ekologjikisht të qëndrueshëm në Kosovë dhe në rajon.

Ndryshimet globale klimatike kanë efekte negative në strukturën dhe funksionimin e ekosistemit në Kosovë. Prandaj, parandalimi i këtyre ndryshimeve në nivel lokal dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe artificiale janë kushte të nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.

Gjithashtu, Kosovës i duhet që, të paktën, të krijojë bazë për shfrytëzimin e energjive të ripërtitshme (p.sh. energjia diellore, e ujit dhe e erës).

Aktivitetet kërkimore-shkencore në të gjitha fushat e lartpërmendura janë, gjithashtu, një faktor i integritetit të Kosovës në organizmat mjedisorë ndërkombëtare që merren me parandalimin dhe me pasojat e ndryshimeve klimatike globale. Përmirësimet në këtë fushë janë, gjithashtu, të rëndësishme për të lehtësuar aderimin e ardhshëm të vendit në Bashkimin Evropian.

5.2.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Në përgjithësi, kapacitetet hulumtuese nuk i mbulojnë të gjitha disiplinat kërkimore-shkencore brenda sektorit të mjedisit.

Për më tepër, aktivitetet kërkimore ekzistuese janë me karakter bazik dhe, në shumë raste, karakterizohen me nisma individuale, edhe pse, aktualisht, në Universitetin e Prishtinës dhe në institutet e tjera kërkimore në Kosovë punojnë rreth 90 anëtarë të stafit akademik dhe shkencor.

Me qëllim të kompletimit të aktiviteteve kërkimore-shkencore në të gjitha fushat e mjedisit, energjisë dhe burimeve natyrore, është i nevojshëm veprim i mëtejshëm drejt zhvillimi të kapaciteteve njerëzore, veçanërisht për kërkime shkencore të zbatuara dhe për hartimin e programeve zhvillimore, zbatimimi i të cilave mund të kërkojë edhe forma të partneritetit publik-privat.

Megjithatë, ka një bazë solide për bashkëpunim me institucionet kërkimore ndërkombëtare, kryesisht mbi bazë të nismave individuale, dhe kjo ka rezultuar më një numër të projekteve dhe publikimeve të përbashkëta në revista ndërkombëtare.

5.2.3. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Në krahasim me standardet botërore për kërkime shkencore në këtë fushë infrastruktura kërkimore shkencore nuk i përmbushë kriteret e cilësisë. Duke pasur parasysh se natyra e kësaj fushe kërkimore shkencore është multidisiplinare, kjo krijon mundësi për qasje të integruar në kërkimin shkencor, shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës dhe të hapësirave laboratorike nga institucione të ndryshme kërkimore-shkencore në këtë fushë. Stafi ekzistues, kryesisht, është i përgatitur për përdorimin dhe mirëmbajtje të infrastrukturës ekzistuese të kërkimit shkencor, kështu që, infrastruktura e re do të kërkojë ngritjen e kapaciteteve njerëzore.

5.2.4. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

- Shfrytëzimi i burimeve natyrore,
- Ngritja e kapaciteteve për zbatimin e qasjes së ekosistemit për menaxhimin e natyrës,
- Menaxhimi i ujit të pijshëm dhe sistemet e trajtimit të ujit të ndotur,
- Trajtimi i ujërave nëntokësore si burim i ujit të pijshëm në zonat rurale,
- Trajtimi i ujit të ndotur në sektorin urban dhe industrial,
- Inventarizimi i florës, faunës dhe kërpudhave në Kosovë,
- Studimi i degradimit të tokës (ndërtimi, konvertimi, fragmentimi, ndotësit, erozioni) dhe konsolidimi i tokës,
- Zbatimi i sistemit të informacionit gjeografik (GIS) në përgatitjen për hartën e ekosistemeve të degraduara dhe rrezikuara,
- Burimet e ndotjes (rrezatimet, metalet e rënda, pesticidet dhe herbicidet) dhe efektet e tyre në qeniet e gjalla,
- Projektimi urban dhe problemet mjedisore.
- Energjia si një instrument për zhvillimin socio-ekonomik,
- Sistemi i energjisë, që nga nxjerrja e energjisë primare tek sistemi i prodhimit të energjisë,
- Energjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm,
- Përmirësimi efektiv i shfrytëzimit të energjisë,
- Kërkesa e integruar dhe mundësia e furnizimit,
- Energjitë e ripërtritshme (diellore, hidroelektrike dhe energjia e erës),
- Konsumi i energjisë dhe popullsia,
- Monitorimi i emetimeve të substancave ndotëse gjatë prodhimit të energjisë, si edhe nga industria e transportit,
- Krijimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm për shkak të efekteve të rrezikshme të ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut,

- Ndotja e mjedisit dhe shëndeti i njeriut, dhe gjendja e ekosistemit nga niveli mikroskopik (molekular) deri te sistemi makroskopik,
- Ndotja e ajrit në mjedise të brendshme dhe efektet në shëndetin e njeriut,

5.3. Prioriteti 2: Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit

5.3.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit konsiderohet sektor strategjik i Kosovës që duhet të ofrojë: siguri dhe ushqim me cilësi të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare, zhvillim të mëtejshëm të prodhimit bujqësor dhe kapaciteteve përpunuese, përmirësim të zinxhirit ushqimor në vend, përmbushje të kërkesës së ushqimit vendor, duke ofruar punësim, ulje të importit të prodhimeve bujqësore dhe rritje të kapaciteteve të eksportit, integrim në organizmat ndërkombëtarë, përmirësim të jetës në zonat rurale, zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje ekonomike në Kosovë.

Megjithëse bujqësia është një sektor i rëndësishëm ekonomik në Kosovë, veprimtaria kërkimore-shkencore në këtë industri mbetet ende në nivel të ulët.

Prodhimi bujqësor në Kosovë karakterizohet nga një sistem tradicional prodhues, prandaj, pa veprimtari kërkimore dhe rezultate shkencore nuk është i mundur menaxhimi i suksesshëm i transformimit të bujqësisë kosovare drejt prodhimtarisë bashkëkohore, në mënyrë që të bëhet konkurruese në treg dhe të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit. Rezultatet e kërkimit inovativ, kryesisht, do të zbatohen në nivel lokal, por nuk është e pamundur që disa prej tyre të gjejnë përdorim edhe në vendet e tjera.

5.3.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Në përgjithësi, në Kosovë numri i hulumtuesve shkencorë në fushën e prodhimit bujqësor dhe të sigurisë së ushqimit është relativisht i vogël, dhe shumica prej tyre janë të punësuar në institucione shtetërore (në Universitetin e Prishtinës dhe në institucione publike kërkimore-shkencore). Aktivitetet kërkimore-shkencore mbeten sporadike dhe marginale, bazuar kryesisht në nismat individuale në sektorin universitar. Në vitet e fundit është krijuar një përvojë e mirë e bashkëpunimit me disa universitete, institute rajonale dhe ndërkombëtare. Janë realizuar projekte të ndryshme kërkimore-shkencore me universitete dhe me institucione ndërkombëtare (ASO, SEEDNET, USAID, KAIP, dhe projekte të financuara nga BE).

Një aspekt i dukshëm pozitiv është se shumë hulumtues të rinj të Kosovës janë duke vijuar studimet dhe/apo janë trajnuar në shumë universitete prestigjioze të vendeve evropiane dhe në rajon. Sidoqoftë, për të krijuar efikasitet në prodhimtarinë bujqësore dhe sistem të sigurisë së ushqimit, i cili funksionon me burimet ekzistuese, ka nevojë për kapacitete të reja njerëzore në fushën e kërkimeve shkencore që do ta përmirësonin gjendjen aktuale.

5.3.3. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Infrastruktura aktuale kërkimore shkencore nuk përkon me kriteret e cilësisë të bujqësisë në botë dhe me standardet e ushqimit. Kjo infrastrukturë është e tejkaluar, e pakompletuar, e shpërndarë në institucione të ndryshme dhe e vjetruar për të kryer hulumtimet e duhura

teknike inovative. Qasjet inovative varen shumë nga kushtet laboratorike dhe nga personeli i duhur.

Stafi ekzistues kërkimor, kryesisht, është i trajnuar për përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ekzistuese kërkimore-shkencore. Zhvillimi i veprimtarive të reja kërkimore shkencore kërkon përmirësimin e infrastrukturës dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Duhet të merret në konsideratë përdorimi efikas, qasja e integruar në kërkime shkencore dhe shfrytëzimi i përbashkët infrastrukturës dhe hapësirave laboratorike nga institucionet e ndryshme kërkimore shkencore.

5.3.4. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

- Siguria e ushqimit, cilësia dhe zbatimi i standardeve të sigurisë në nivel të fermës dhe njësive përpunuese,
- Teknologjitë e reja për të rritur prodhimin bujqësor,
- Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë (tokës, kafshëve, bimëve, ujitjes, etj),
- Prodhimi i kafshëve, përmirësimi dhe shëndeti i tyre,
- Prodhimi bimor, përmirësimi dhe mbrojtja e bimëve,
- Kontrolli i zoonozave,
- Ndikimi i ndryshimeve globale në prodhimin bujqësor,
- Vlera e shtuar për prodhimet bujqësore duke përmirësuar përpunimin dhe aktivitetet e marketingut,
- Përmirësimi i konkurrencës së prodhimeve bujqësore dhe zëvendësimi i importit me eksport në tregjet e tjera,
- Mbështetje zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmirësimi i cilësisë së jetës përmes promovimit të aktiviteteve bujqësore dhe atyre jobujqësore pa shkaktuar ndonjë dëm në burimet e mjedisit,
- Mbështetje prodhimit bujqësor dhe shumëllojshmërisë rurale,
- Ruajtja e diversitetit të burimeve gjenetike bujqësore (kafshëve dhe bimëve),
- Rritja e prodhimit dhe shfrytëzimi i pyjeve,
- Përafrimi i politikave të bujqësisë në Kosovë me ato të BE-së.

5.4. Prioriteti 3: Kërkimet shkencore në mjekësi

5.4.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Për shkak të faktorëve të shumtë, viteve të fundit është parë rritje e shpejtë e paraqitjes së shumë problemeve të shëndetit të njeriut në gjithë botën. Kosova ka një sistem shëndetësor që ka pësuar reforma në të gjitha nivelet.

Si çdo vend, edhe Kosova është e obliguar që të mbështesë aktivitetet kërkimore në mjekësi për përcaktimin e diagnozave, të terapisë dhe për qëllime edukative. Kjo ndikon në ofrimin e shërbimeve efektive mjekësore, përcaktimin e faktorëve të veçantë etiologjikë dhe

parandalimin e sëmundjeve, diagnostifikimin dhe terapinë e arsyeshme të sëmundjeve, zvogëlimin e prevalencës dhe paraqitjes së sëmundjeve me rëndësi socio-ekonomike, zvogëlimin e faktorëve të rrezikut për shëndetin për vendin dhe rajonin, përcaktimin e duhur të politikave shëndetësore në përputhje me standardet ndërkombëtare. Përkrahja e hulumtimeve mjekësore është gjithashtu parakusht për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë mjekësor. Në përgjithësi, zhvillimi i aktiviteteve kërkimore në mjekësi është, gjithashtu, i rëndësishëm për sigurimin e shërbimeve shëndetësore me cilësi të lartë për popullatën duke zbatuar rezultatet e kërkimeve në praktikat lokale klinike (publike dhe private), ndoshta edhe jashtë vendit.

5.4.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Ndonëse stafi ekzistues është i përkushtuar për të ofruar shërbime kreative dhe inovative në fushën e mjekësisë, kapacitetet kërkimore nuk i mbulojnë të gjitha disiplinat.

Zhvillimi i teknologjive të reja, zbatimi i trajtimeve të reja, si për sigurinë ashtu edhe për efikasitetin, dhe të gjitha hulumtimet e tjera që kontribuojnë në zhvillimin e trajtimeve të reja, imponojnë nevojën për rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve njerëzore në fushën e mjekësisë.

Gjatë dekadës së fundit, shumë hulumtues të rinj shkencorë të Kosovës nga fusha të ndryshme të mjekësisë kanë kryer studime dhe specializime në shumë universitete prestigjioze botërore, pra, ekziston një ekspertizë solide për hulumtime gjithëpërfshirëse.

Edhe pse aktivitetet kërkimore mbeten sporadike dhe marginale, bazuar kryesisht në nisma individuale në sektorin universitar, ka dëshmi për rritje të bashkëpunimit me institucionet kërkimore ndërkombëtare. Është ofruar mbështetje e rëndësishme për kërkime në fushën e shëndetësisë në Kosovë nga organizata ndërkombëtare si OBSH, UNICEF, USAID, WUS, UNFPA, DFID, etj. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërkombëtar do të forcojë mendimin shkencor dhe veprimtarinë kërkimore- shkencore në mjekësinë bazike dhe të zbatuar.

5.4.3. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Veprimtaria ekzistuese kërkimore-shkencore në Kosovë në fushën e mjekësisë është e shpërndarë në shumë institucioneve.

Në përgjithësi, bashkëpunimi ndërkombëtar është në nivelin e ndërtimit të kapaciteteve njerëzore dhe, shumë më pak, për ofrimin dhe përmirësimin e infrastrukturës kërkimore-shkencor. Ekzistojnë hapësira fizike për hulumtime, por, në Kosovë, ekziston nevoja për laboratorë dhe pajisje më të mira. Stafi ekzistues është përgatitur vetëm për përdorimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës kërkimore ekzistuese, kështu që infrastruktura e re do krijojë nevojën për ndërtimin e kapaciteteve njerëzore.

Korniza ligjore e hulumtimit eksperimental duhet të kompletohet dhe të përshtatet në përputhje me Konventën ndërkombëtare.

5.4.4. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

Përqendrimi duhet të jetë në hulumtime për të siguruar masa, politika dhe ndërhyrje efektive në përputhje me standardet e BE-së. Duhet të krijohen partneritete ndërdisiplinore përfshirë

shkencat bazike, hulumtimet klinike dhe epidemiologjike, biostatistikën, bioinformatikën, dhe partneritetet profesionale.

Temat prioritare në fushën e hulumtimit shkencor në mjekësi janë:

- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e mjekësisë bazike (hulumtime gjenetike, imunologjike dhe farmakoterapeutike),
- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e mjekësisë klinike (hulumtimi i sëmundjeve kardiovaskulare dhe onkologjike),
- Zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore në shëndetin publik (parandalimi dhe kontrolli i sëmundjeve infektive, shëndeti mendor, shëndeti i nënës dhe i fëmijës dhe varshmëria nga substancat e ndryshme).

5.5. Prioriteti 4: Studimet shoqërore dhe ekonomike

5.5.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Gjatë represionit të viteve të nëntëdhjeta në Kosovë ndodhi një shkatërrim i kapaciteteve të prodhimit në të cilat mbështetej ekonomia e Kosovës deri në vitin 1990. Gjatë dekadës së kaluar, vendi i ishte nënshtruar edhe izolimit ekonomik. Si rezultat ka ndodhur një ndërprerje e marrëdhënieve midis entiteteve të biznesit në Kosovë dhe partnerëve të tyre në republikat e tjera të ish-Federatës Jugosllave dhe në rrafshin ndërkombëtar. Kjo i ka lënë politikëbërësit në Kosovë pa bazë të rëndësishme industriale që do të çojë në zhvillimin e vendit në të ardhmen. Tri përpjekjet e ndërmarra për të zhvilluar strategji për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit në të ardhmen, e të cilave nuk u kanë paraprirë projekte serioze kërkimore, kanë dështuar.

Zhvillimi ekonomik, punësimi dhe rritja e konkurrencës janë sfidat më të rëndësishme me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare në të ardhmen. Hulumtimi shkencor duhet t'i sigurojë përgjigjet kryesore që hartuesit e politikave do të kenë nevojë t'i dinë për vendimet e tyre strategjike për strukturën e ardhshme ekonomike, strategjinë e arsimit, kornizën ligjore dhe institucionet e sigurisë që të sigurohet një mjedis për zhvillim të suksesshëm ekonomik dhe shoqëror. Hulumtimi duhet të zhvillojë njohuri të reja për përdorim më efektiv të të gjitha burimeve njerëzore, natyrore dhe financiare të Kosovës drejt zhvillimit të një shoqërie të re të bazuar në dije; të mundësojë integrimin në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet zhvillimit të një strukture të përshtatshme ekonomike dhe shkathtësi adekuate të punës; dhe tërheqjen e investimeve të huaja duke siguruar stabilitet institucional dhe sundimin e ligjit dhe sigurisë publike.

5.5.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Ndonëse ekziston një numër i hulumtuesve aktivë në fushën e ekonomisë, të drejtësisë, të arsimit dhe në shkencat e tjera sociale, kapacitetet e hulumtuesve shkencorë kosovarë për të dizajnuar/realizuar hulumtime cilësore dhe sasiore janë të kufizuara. Aktualisht, Universiteti i Prishtinës nuk ofron ndonjë formë të kurseve për dizajnimin/organizimin e projekteve kërkimore dhe institucionet kërkimore varen nga hulumtuesit e huaj, nëse hulumtimi kërkon dizajn shkencor eksperimental, kuazi-eksperimental apo ndër-sektorial.

Mungesa e përvojës në zhvillimin e shkallëzimit dhe në analiza multivariacionale i kufizon hulumtimet lokale në kërkime deskriptive. Kërkohet një angazhim i madh për të promovuar ndërgjegjësimin se këto aftësi hulumtuese/kërkimore janë të nevojshme për hulumtues. Këto duhet të konsiderohen si një parakusht i motivimit të tyre për të ndërmarrë përpjekje serioze për përmirësimin e aftësive për punë hulumtuese, aftësi të cilat janë në presion zhvillues si rezultat i hulumtimeve komplekse të zbatuara sot në ekonomi, drejtësi, arsim dhe fusha të tjera të shkencave shoqërore.

Për shkak të mungesës së kapaciteteve për dizajnimin e kërkimeve shkencore, në fushën e shkencave shoqërore, publikimet e autorëve kosovarë në revista me reputacion janë të rralla, dhe kryesisht janë rezultat i bashkëpunimit të autorëve kosovarë me institucione ndërkombëtare apo si rezultat i hulumtimit të përbashkët gjatë vizitave të tyre në institucione kërkimore të huaja. Mungesa e stimulimit për veprimtari kërkimore-shkencore në Kosovë e ka zvogëluar veprimtarinë e hulumtuesve kosovarë të kthyer nga bota e jashtme, dhe si rezultat, ata janë shndërruar në hulumtues pasivë të shtyrë të merren me veprimtari të tjera si mësimdhënie apo konsulencë jo-shkencore. Ndërkohë që ka thirrje për kthimin e ekspertëve në formën e programeve të "kthimit të trurit", kërkohen stimule serioze që kthimi të jetë efektiv, duke përfshirë fonde të mjaftueshme për veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore dhe themelimin e skemave për zhvillimin e aftësive hulumtuese të kandidatëve që janë në fillim të karrierës së tyre hulumtuese.

5.5.2. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Shkencat shoqërore nuk janë shumë të varura nga laboratorët. Disa zyre dhe pajisje themelore për informatikë janë në dispozicion në institucione të shkencave shoqërore. Problemi kryesor për hulumtime në fushën e shkencave shoqërore në Kosovë është mungesa e të dhënave zyrtare statistikore për zhvillimet ekonomike dhe shoqërore. Edhe pse pritet të jetë vështirë të ketë të dhëna të besueshme në një vend me një nivel të lartë të ekonomisë informale, megjithatë qeveria dhe agjencitë qeveritare nuk e kanë zhvilluar një bazë të të dhënave të besueshme në lidhje me proceset e mëdha ekonomike dhe shoqërore. Një nga shqetësimet më të mëdha për hulumtimet në të ardhmen janë bibliotekat e varfra dhe mungesa e revistave ndërkombëtare në bibliotekat e Kosovës.

Institucionet hulumtuese dhe arsimore duhet të zhvillohen brenda kornizës së integruar të trekëndëshit efektiv (arsimi-shkenca-inovacioni), duke kultivuar shprehitë e mësimin gjatë gjithë jetës të hulumtuesit dhe bashkëpunimit me qendra të rëndësishme kërkimore ndërkombëtare.

5.5.3. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

1. Studime për identifikimin e faktorëve që ndikojnë në shfrytëzimin efektiv të burimeve njerëzore, natyrore dhe financiare të Kosovës, drejt zhvillimit të një shoqërie të bazuar në dije, përfshirë, por jo të kufizuara, në këto përmbajtje:
 - Hulumtime mbi promovimin e vargut të vlerave (nga prodhimi primar, përpunimi dhe marketingu i produkteve vendore) që përfshin studime në fushën e prodhimit dhe konsumit,
 - Hulumtime për faktorët që ndikojnë në integrimin e Kosovës në tregjet ndërkombëtare,
 - Hulumtime për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja,

- Hulumtime për faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe natyrën e marrëdhënie me partnerët e huaj,
 - Hulumtime në lidhje me ndikimin/efektin e stabilitetit institucional dhe sundimin e ligjit në zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.
2. Studime për zhvillimin e arsimit dhe të institucioneve kërkimore që ofrojnë një kuadër të integruar të trekëndëshit efektiv arsim-shkencë-inovacion.
 3. Studime për qeverisjen, që përfshijnë sa vijon më poshtë:
 - Hulumtime për qeverisjen ekonomike, në nivelin makro dhe mikro,
 - Studime për sundimin e ligjit brenda kornizës së integritit evropian,
 - Hulumtime për sigurinë publike, si për institucione ashtu edhe për individë,
 - Hulumtime për qeverisje elektronike dhe shërbime elektronike për publikun,
 - Hulumtime për qeverisje financiare dhe zvogëlimin e informalitetit,
 - Hulumtime për zgjidhjen e problemeve sociale si varfëria dhe papunësia, si dhe për zhvillimin e tregut të punës, të prodhimit dhe të shërbimeve.
 4. Hulumtime për zhvillimin e kohezionit, të solidaritetit dhe të integritit social. Studime për rrjedhat e normave shoqërore dhe të sjelljes në funksion të integritit në BE.

5.6. Prioriteti 5: Studimet gjuhësore, kulturore dhe historike

5.6.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Studimet gjuhësore ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin e komunikimit dhe të transmetimit të dijes, të simboleve dhe vlerave, gjë që po ashtu ndikon në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit. Studimet kulturore janë të rëndësishme për të kuptuar marrëdhëniet ndërmjet grupeve dhe kategorive shoqërore, si dhe për të kuptuar proceset dhe praktikatat e përgjithshme sociale, modelet bazike kulturore dhe proceset e ndryshimit dhe të interaktivitetit ndërmjet kulturave. Studimet kulturore kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të vendit. Studimet historike kontribuojnë në zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë kosovare, duke ngritur vetëdijen dhe zhvilluar njohuritë për ngjarjet dhe proceset historike nëpër të cilat ka kaluar vendi. Këto studime ndikojnë në ruajtjen e vlerave muzeore dhe arkivore si dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit.

5.6.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Në Kosovë, ekziston një numër i konsiderueshëm i studiuesve në fushën e gjuhësisë. Megjithatë, numri i tyre në disiplina si sociolinguistika, psikolinguistika, stilistika dhe në gjuhësinë e aplikuar është i kufizuar. Ekziston një numër i konsiderueshëm i ekspertëve me përvojë ndërkombëtare në kryerjen e hulumtimeve në studimet kulturore, por angazhimi i hulumtuesve të rinj është një domosdoshmëri. Në Kosovë dhe diasporë vepron një numër i hulumtuesve shkencorë për të gjitha periudhat e studimeve historike.

5.6.3. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Gjendja e infrastrukturës për kërkime në fushën e gjuhësisë në Kosovë nuk ndryshon nga gjendja në fushat e tjera të hulumtimit. Në përgjithësi, kushtet për kërkime në hulumtimet gjuhësore nuk përshtaten me standardet bashkëkohore. Në nivel institucional, infrastruktura kërkimore që do të siguronte qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e studimeve kulturore në Kosovë është e pamjaftueshme. Situata me studimet historike është më e mirë, pasi që infrastruktura kërkimore ekzistuese mbështet zbatimin e projekteve kërkimore në një nivel të kënaqshëm. Megjithatë, mungon infrastruktura e nevojshme për ekspedita arkeologjike, restaurime dhe revitalizime, arkivime të dokumenteve dhe materialeve muzeore etj.

5.6.4. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

1. Studime për aspektin praktik të komunikimit efektiv në të gjitha nivelet dhe strukturat politike dhe shoqërore, si një funksion strategjik për të gjitha fushat e tjera, përfshirë, por jo vetëm, këto tema:
 - Krijimi i bazës së të dhënave për Korpusin e Shqipes në formë elektronike, si bazë e domosdoshme për kërkimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme në fushën e leksikografisë, të hulumtimit strukturor dhe të shumë nevojave të tjera praktike (përfshirë burimet njerëzore, infrastrukturën, harduerin dhe përshtatjen/zhvillimin e softuerëve, etj).
 - Hulumtime për përdorimin e gjuhës në media dhe komunikim publik, arsim, kulturë, politikë, shkencë dhe biznes në pikëpamje të standardeve ekzistuese, shtresave shoqërore, dhe në lidhje me zhvillimet e mëtejshme në kuadrin e horizonteve evropiane të shoqërisë kosovare.
 - Varietetet gjuhësore dhe identiteti: raportet ndërmjet identitetit social/grupor dhe varieteteve të rëndësishme të gjuhës për çdo grup.
 - Hulumtime për burimet strukturore, leksikore dhe të tjera të gjuhës shqipe, veçanërisht në lidhje me horizontet e reja në kuadrin e shoqërive evropiane dhe perëndimore (terminologji në ekonomi, financa, drejtësi, shoqëri dhe në fusha të tjera me rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror).
 - Studime për marrëdhëniet midis shqipes dhe gjuhëve të tjera të Evropës Juglindore me qëllim të krijimit të kontakteve të ngushta ndërmjet shoqërive përkatëse në rajon (hulumtim dhe mësim të gjuhëve).
 - Përdorimi dhe mësimi i gjuhës në kontekstin e arsimimit.
 - Mësimi i gjuhës për fëmijët e diasporës
 - Studimet gjuhësore tek arbëreshët dhe shqiptarët në vendet si Turqia, Greqia, Italia, Egjipti, Rumania etj.
 - Studimet gjuhësore në fushën e informatikës dhe të teknologjisë
 - Studimet në fushën e terminologjisë shkencore dhe të standardizimit të terminologjisë në gjuhën shqipe
 - Studimet gjuhësore në fushën e historisë së gjuhës dhe të filologjisë klasike
2. Studime shumëdisiplinore të shoqërisë kosovare nga perspektiva kulturore, letrare, artistike dhe folklorike.

- Hulumtime të vlerave, qëndrimeve, botëkuptimeve dhe ndryshimeve në mënyrën e jetesës dhe të të menduarit.
- Hulumtime të identiteteve sociale dhe kulturore, të subkulturave dhe të multikulturalizmit në kohën e integritit dhe të globalizmit.
- Hulumtime në fushën e gjinive dhe të reprezentimit social.
- Hulumtime nga fusha e arteve (muzikës, arteve pamore, letërsisë, teatrit, filmit etj.), kulturës popullore, traditës dhe folklorit.
- Studimet e letërsisë në aspektin historik, kritik dhe teorik.
- Studimi filologjik dhe botimi kritik i veprave nga trashëgimia si dhe studimet komparativiste të letërsisë.
- Hulumtime nga fusha e sportit dhe lojërave.
- Hulumtime nga fusha e mjedisit jetësor, urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.
- Hulumtime nga fusha e medieve, komunikimit publik dhe reprezentimit social.

3. Studimet historike që do të promovojnë identitetin kombëtar dhe historinë e Kosovës

- Hulumtimet nga parahistoria.
- Hulumtime të epokës së antikitetit dhe të mesjetës.
- Hulumtime të modernitetit, lëvizjeve kombëtare, shtetësisë dhe demokracisë.
- Hulumtime për shkencat ndihmëse të historisë (arkeologji, arkivistikë, etj.).
- Studime nga fusha e historisë shoqërore-ekonomike, shpirtërore dhe gojore.

5.7. Studime ndër-horizontale në Teknologjinë Informativë dhe Komunikuese

5.7.1. Rëndësia për zhvillimin e vendit

Sipas studimit “Parashikimi i tregut të TI-së në Kosovë 2008-2012 dhe Aksionet e Kompanive në vitin 2007” nga kompania hulumtuese IDC Adriatics³, tregu i TI-së në Kosovë në vitin 2007 kishte arritur \$85.17 milion duke u zgjeruar përafërsisht 30% në vit deri në vitin 2007. Shpenzimet e përgjithshme të TI-së në Kosovë në vitin 2007 sipas sektorëve ishin si vijon:

- Shpenzimet për rishitjen e harduerit kapin 74%
- Shpenzimet për softuer kapin përqindjen prej 13.1%, dhe
- Shërbimet e TI-së kapin përqindjen prej 12.9%.

nga totali i përgjithshëm i shpenzimeve për TI-së. Me \$40 të shpenzimeve për TI për kokë banori në vitin 2007, Kosova qëndronte në 4.5% të mesatares së 27 shteteve të BE-së (\$886 për kokë banori). Po ashtu, Kosova ka mbetur mbrapa me shpenzimet mesatare të TI-së në rajonin e Adriatikut, veçanërisht në raport me Slloveninë (\$455) dhe Kroacinë (\$276), por qëndron afër me nivelin e shpenzimeve të TI-së me Bosnjë dhe Hercegovinën (\$42) dhe ishte më e avancuar se Shqipëria fqinje (\$25).

³ <http://www.newKosovoreport.com/200812221508/Business-and-Economy/IT-market-in-Kosovo-small-but-growing.html>

Për më tepër, duke iu referuar të njëjtit studim të IDC, shpenzimet e TI-së në Kosovë pritet të rriten me normë vjetore prej 9.9% gjatë një periudhe pesëvjeçare për të arritur në 136.73 \$ milion në vitin 2012. Duke pasur parasysh këtë trend dhe rëndësinë e TIK-ut për zhvillimin e çdo lloj kërkimi, kjo fushë konsiderohet të jetë me rëndësi të madhe në kontekstin e Kosovës.

5.7.2. Gjendja e burimeve njerëzore në veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe zhvillimore

Një analizë e vonshme e gjendjes së TIK-ut në Kosovë⁴ tregon se janë 114 të punësuar në fushën e kërkimeve dhe zhvillimit në TIK, prej të cilëve 17 janë me thirrje të doktorit të shkencave, të punësuar me orar të plotë pune. Megjithatë, mungesa e fondeve hulumtuese ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në zhvillimin e kapaciteteve të reja në këtë fushë, kështu që numri i studiuesve të moshës 35 vjeç dhe më të rinj akoma nuk ka arritur një të tretën e popullacionit të përgjithshëm. Nga ana tjetër, ekziston një potencial në diasporën kosovare në Evropë dhe ekziston një bashkëpunim akademik mes ekspertëve të TIK-ut me origjinë kosovare që punojnë në Evropë dhe institucioneve kërkimore në Kosovë. Disa studiues kosovarë të TIK-ut, po ashtu, janë trajnuar në kuadër të projekteve KAIP dhe WINS-ICT për të marrë pjesë në Programin Kornizë Evropian për KZhT.

5.7.3. Gjendja e infrastrukturës kërkimore-shkencore

Në krahasim me infrastrukturën e dobët dhe të vjetruar në shumë fusha të tjera të veprimtarisë kërkimore-shkencore gjendja e infrastrukturës së TIK-ut në Kosovë konsiderohet të jetë e pranueshme. Megjithatë, mirëmbajtja e dobët dhe fragmentimi i infrastrukturës shpesh e bëjnë atë të padobishme për projekte kërkimore serioze. Nga ana tjetër, krahasuar me infrastrukturën hulumtuese shkencore në vendet e zhvilluara, infrastruktura ekzistuese në Kosovë është mjaft e vjetruar dhe nuk mundëson pjesëmarrjen e institucioneve kërkimore të Kosovës në projektet kërkimore ndërkombëtare. Objektet kryesore për veprimtari kërkimore-shkencore në TIK në Kosovë janë:

1. Laboratorët e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës,
2. Posta dhe Telekom i Kosovës,
3. Të gjitha labororet e institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të tjera publike dhe private që merren me këtë veprimtari.

5.7.4. Temat që duhet të trajtohen në kuadër këtij prioriteti kërkimor-shkencor

- Risitë e TIK-ut me përqendrim në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe sociale, sigurimin e të dhënave dhe analizave për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.
- Kontributi i TIK-ut për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe mirëqenien sociale, si dhe rolin e saj në lëvizjen drejt shoqërisë së bazuar në dije.
- Zbatimi i inovacioneve të reja si rrjetet elektrike “smart”, telemjekësia, rrjetet inteligjente të transportit, mësimi interaktiv dhe informatika si mjete për operim efikas dhe rrjete të komunikimit të shpejtë.
- Roli i TIK-ut në ndryshimet klimatike (perspektivë në të ardhmen).

⁴ Ahmedi L, Sylemani K: National Background Report on ICT Research in Kosovo, WBC-INCO.net, Prishtina, November 2009

- Përdorimi i TIK-ut nga nivelet zyrtare për të zhvilluar një kornizë konceptuale në fusha të ndryshme (në ekonomi, në mjedis, në sistemin arsimor, në sistemin shëndetësor, në administratën publike, etj).
- Promovimi i përmbajtjes relevante të informacionit, mirëbesimit, lirisë së mendimit dhe potencialeve të tjera për inovacion në shoqëri.
- Zhvillimi i rrjeteve "future content".

5.8. Korniza ndërkombëtare për prioritetet kombëtare shkencore dhe zhvillimore të Kosovës

Gjatë 20 vjetëve të fundit, shumë vende ekonomikisht të zhvilluara kanë hartuar strategjitë kombëtare për Sh&T përfshirë edhe caktimin e prioriteteve. Lista e vendeve është vazhdimisht në rritje dhe përfshin gjithnjë e më shumë ekonomi në zhvillim. Vlen të theksohet, se, në disa vende, ka ekzistuar një shumëllojshmëri e programeve për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore edhe para se kornizat strategjike ("Überbau") për Sh&T (dhe rrjedhimisht edhe për programe kërkimore-shkencore) të jenë bërë eksplicite dhe të kodifikuara. Në këtë aspekt, Kosova, për të thënë kështu, nuk është vetëm. Në fakt, veprimtaria gjithëpërfshirëse kërkimore-shkencore, zhvillimi teknologjik dhe strategjia inovative akoma mungojnë në Kosovë, por ky Program Kombëtar i Shkencës inkorporon shumë elemente strategjike, të cilat mund të konsiderohen si standarde të nevojshme dhe qasje gjithëpërfshirëse për krahasim me ato ndërkombëtare.

Një element i rëndësishëm në Evropë për sa i përket përcaktimit të prioriteteve hulumtuese ka qenë Programi Evropian Kornizë për Kërkim dhe Zhvillim Teknologjik. Për shumë vende evropiane ky Program Kornizë, i cila ekziston që nga viti 1980, është pikë referimi për caktimin e prioriteteve në Sh&T. Programet kornizë janë programet më të mëdha në botë të KZhT dhe përmbajnë elemente të caktimit të prioriteteve në Sh&T që burojnë nga paradigma e "teknologjive civile kyçe" (kohët e fundit me një fokus të veçantë në teknologjitë bashkëkohore siç është TIK-u, bioteknologjia, nano-teknologjia dhe shkencat kognitive), por edhe të qasjeve sistematike (p.sh. nocioni i projekteve bashkëpunuese, të kuptuarit gjithëpërfshirës të KZhTI, gjithëpërfshirja, etj). Në të vërtetë, ato edhe orientojnë veten e tyre drejt misioneve të reja të përshkruara si "sfida të mëdha" të së ardhmes sonë (p.sh. ndryshimet klimatike; shoqëria drejt plakjes; regjimet e energjisë post- karbonike, etj).

Që kur Programi Kornizë i Evropës për KZhT është bërë burim i rëndësishëm financimi për shumë vende të Evropës Juglindore (emërtuar me termin "Vendet e Ballkanit Perëndimor"), dhe me shpresë që, në një të ardhme të afërt, të bëhet burim edhe për Kosovën, është me rëndësi që caktimi i prioriteteve në Kosovë të mos jetë në kundërtënie me trendet kryesore Evropiane dhe botërore sa i përket financimit të KZhT. Krahasimi ynë tregon se nuk kemi të bëjmë me një situatë të tillë. Lidhje e qartë tematike ekziston në prioritetin kërkimor 1 ("Burimet natyrore, energjia dhe mjedisi), prioritetin kërkimor 2 ("Prodhimi bujqësor dhe siguria e ushqimit"), dhe në prioritetin kërkimor ndër-horizental ("Teknologjia informative dhe komunikuese"). Gjithashtu, në prioritetin kërkimor 3 ("Studime në fushën e mjekësisë") dhe në prioritetin kërkimor 4 ("Studimet shoqërore dhe ekonomike") ekziston një lidhshmëri, edhe pse disa nga fushat kërkimore-shkencore në këto dy prioritete janë më specifike për sfidat në Kosovë. Vetëm lidhja tematike e prioritetit kërkimor 5 ("Gjuhësia dhe studimet kulturore-historike") është diç më e kufizuar për shkak të elementit të fortë kombëtar në këtë prioritet kërkimor. Përveç faktit se, në shumë aspekte, teorikisht ekziston lidhshmëri me programin më të madh në botë për KZhT, nuk duhet nënvlerësuar se niveli i ulët i kërkimit në

Kosovë mund ta vështirësojë përfshirjen më të madhe të hulumtuesve kosovarë në rrjetet hulumtuese evropiane dhe botërore.

Nga këndvështrimi i potencialit të tyre për të mundësuar lidhjen bilaterale me programet kërkimore të vendeve të tjera, të gjitha prioritetet kombëtare të identifikuara të KZhT në Kosovë janë shpresëdhënëse. Pothuaj se nuk ka vend evropian që nuk vë theksin e veçantë në TIK, hulumtime në mjekësi, mjedis dhe energji ose që nuk e vë theksin në bujqësi apo sigurinë e ushqimit, shkenca shoqërore (posaçërisht studimet që prekin ndryshimet shoqërore drejt të ashtuquajturës shoqëri e bazuar në dije) dhe shkenca humane. Kështu, është dhënë një bazë e mirë për ndërtimin e programeve bilaterale ndërqeveritare në Sh&T. Lidhja e fortë e gjuhës shqipe dhe e kulturës shqiptare, sidoqoftë, mund të trajtohet më së miri përmes një bashkëpunimi të ngushtë me shtetet fqinje si Maqedonia dhe Shqipëria, më të cilat marrëveshjet për Sh&T tanimë ekzistojnë. Duhet theksuar gjithashtu aspektet ballkanistike, si një dimension i rëndësishëm i ndërlidhjes dhe i hapjes drejt traditave të tjera.

6. Plani Zbatues

6.1. Plani i aktiviteteve dhe orari

Tabela e mëposhtme paraqet orarin e zbatimit të hapave kryesorë që duhet të ndërmerren për të jetësuar këtë Program Kombëtar të Shkencës për prioritetet e identifikuarra kërkimore. Ajo lidh çdo aktivitet me një objektiv të përgjithshëm dhe tregon përgjegjësinë, kohëzgjatjen, burimet e nevojshme dhe buxhetet.

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtari kërkimore- shkencore

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|------|--|--|--|--|--|
| 1.1 | Themelimi i programeve të doktoratës për edukimin e shkencëtarëve të rinj në mjedise të shquara institucionale (p.sh. brenda programeve të përbashkëta ndërkombëtare që çojnë në tituj të dyfishtë | 2011 gjysma e parë Konkursi i parë - 2011 Konkursi i dytë - 2014 | 5 programe të doktoratës për kohëzgjatjen 3 + 3 vjet | 100.000,00 € për secilin program të doktoratës; Gjithsej 500.000,00€ në vit | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 1.2 | Bursat për studiues individualë të pasdoktoratës për nxitje të karrierës shkencore në fushat prioritare | 2012 gjysma e dytë | Ndarja e 10-15 bursave brenda vitit | 20, 000€ për secilën bursë (secila zgjat deri në 10 muaj); Gjithsej rreth 250.000,00 € në vit | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 1.3 | Bursat individuale të doktoratës për nxitjen e karrierës shkencore në fushat prioritare (si në vend ashtu dhe jashtë vendit) | 2010 gjysma e dytë | Ndarja e 20 bursave brenda vitit | 14,000.00€ për secilën bursë në vit (duhet rezervuar mjete financiare për 3 vjet dhënie burse), gjithsej 280.000,00 € në vit. Kësti i parë në 2011 | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 1.4 | Bursat për mobilitete afatshkurtra për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis institucioneve vendore dhe atyre mikpritëse për avancimin e bashkëpunimit të shkencave. | 2010 gjysma e dytë | Ndarja e 20 bursave brenda vitit | 1,500.00€ për bursë; gjithsej 30,000€ në vit | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Objektivi 2: Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore–shkencore

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------|---|--------------------|--|--|--|
| 2 | Miratimi i Programit Kombëtar të Shkencës | 2010 gjysma e dytë | Afatgjate për një periudhë prej 5 vitesh deri në shqyrtimin e ardhshëm | Burimet e brendshme (ekspertiza e jashtme financuar nga projekti austriak - KAIP) | Kuvendi i Kosovës |
| 2.1 | Zhvillimi i infrastrukturës ligjore përmes rishikimit të Ligjit ekzistues për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, eventualisht hartimit të një ligji për financimin e kërkimeve shkencore | 2010 gjysma e dytë | Afatgjatë (deri në rishikimin e ardhshëm) | Burimet e brendshme (eventualisht ekspertiza e huaj e financuar përmes projektit austriak-KAIP) | MASHT, Kuvendi i Kosovës |
| 2.2.1 | Zhvillimi i kapacitetit për menaxhimin e programeve kërkimore-shkencore | 2010 gjysma e dytë | Afatgjatë (raportim dhe shqyrtim i vazhdueshëm) | Profesionalizimi i QKBNSHT dhe QITT, dhe, eventualisht, përfshirja në Agjencinë Kombëtare për Promovimin e Shkencës; Trajnimi i 5 menaxhereve të programit me orar të plotë të punës (eventualisht të trajnuar në kuadër të projektit austriak-KAIP) | MASHT |
| 2.2.2 | Financimi konkurrues i rrjetit kombëtar të infrastrukturës kërkimore dhe i laboratorëve qendrorë kombëtarë në fushat kërkimore prioritare. | 2010 gjysma e dytë | 5 rrjete kombëtare të infrastrukturës kërkimore (ose laboratore kombëtare qendrore) financohen për 2 vjet për t'u vënë në funksion | 250,000.00€ për secilin projekt; 1,250,000.00€ gjithsej | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|---|------------------------|---------------------------------|---|--|
| 2.2.3 | Financimi i projekteve të veçanta për sigurimin e pajisjeve në bazë të planeve të zhvillimit shkencor dhe procedurave konkurruese të tenderimit | 2012 gjysma e parë | Unike me një ndikim afatgjatë | 1,000,000.00€ të shpërndara në më së paku 20 projekte | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 2.3 | Blerja ose zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi informativ të KZhT, i cili, gjithashtu, u shërben kërkesave të statistikave kombëtare të Sh&T | 2011 gjysma e parë | Operacioni afatgjatë i sistemit | 100,000.00€ në vitin e parë; 50,000.00€ në secilin nga vitet në vijim (termat e referencës etj eventualisht i mbështetur nga projekti Austri-Kosovë, KAIP) | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 2.4 | Sigurimi i aksesit të studiuësve kosovarë në bibliotekat përkatëse elektronike (p.sh. Thomson Web of knowledge; SCOPUS etj) | 2011 gjysma e parë | Abonimi dhe leja vjetore | 200,000.00€ | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore–shkencore

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|---|------------------------|--------------------|----------------------------|--|
| 3.1.1 | Themelimi dhe funksionimi i një fondi për mbështetjen e publikimeve shkencore dhe komunikimeve shkencore | 2010 gjysma e dytë | Në vazhdimësi | 50,000.00 € në vit | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 3.2 | Grante për përgatitje të projekteve për të aplikuar si pjesë e konsorciumeve ndërkombëtare për financim evropian në kuadër të COST, në veçanti Programi Evropian Kornizë për KZhT | 2011 gjysma e parë | Në vazhdimësi | 50,000.00€ në vit | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|--|------------------------|------------------------------|---|--|
| 3.3 | Sigurimi i granteve në bazë konkurruese për projekte të përbashkëta me institucione të huaja partnere financuar nga programe bilaterale ndërqeveritare për KZhT të nënshkruara midis Kosovës dhe vendeve të tjera, ose për skema të tjera një-, dy- dhe shumëpalëshe | 2011 gjysma e dytë | Në bashkërendim me partnerët | 5.000,00€ për çdo projekt të përkrahur; Maksimum 30 projekte të përkrahura në vit; Gjithsej maksimum 150,000.00€ në vit | MASHT |
| 3.4 | Themelimi dhe funksionimi i një fondi “kthimi i trurit “ për të tërhequr studiues të huaj dhe, në veçanti, studiues kosovarë që punojnë jashtë vendit. | 2010 gjysma e dytë | Në vazhdimësi | €250,000.00 në vjet | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Objektivi 4: Forcimi i lidhjeve midis shkencës, shoqërisë dhe ekonomisë për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|---|------------------------|---|---|--|
| 4.1 | Krijimi i një grupi pune për përgatitjen e një programi të aplikuar të KZhT | 2012 gjysma e parë | Afatgjate (deri në rishikimin e ardhshëm) | Burimet e brendshme (eventualisht ekspertizë e huaj e financuar përmes projektit austriak-KAIP) | MASHT |
| 4.2 | Fillimi i programit të aplikuar të KZhT | 2014 gjysma e parë | Konkursi duhet të publikohet dy herë në vit | 500,000.00€ për minimum 10 projekte të financuara, të paguara gjatë 2 vjetëve | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|--|------------------------|---|---|---------------------|
| 4.3 | Krijimi i një grupi pune për të përgatitjen e një programi inovativ bashkëpunues | 2014 gjysma e parë | Afatgjatë (deri në shqyrtimin e ardhshëm);një konkurs inovativ duhet të publikohet në vitin 2016, por me mjete nga burime të ndryshme (duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave) | Burimet e brendshme (eventualisht ekspertizë e huaj e financuar përmes projektit austriak-KAIP) | MASHT |

Objektivi 5: Përsosmëri në veprimtarinë kërkimore-shkencore

| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|--|------------------------|---|---|--|
| 5.1 | Financim konkurrues i pesë qendrave kombëtare për përsosmëri në fushat prioritare shkencore (sidomos në teknologji bashkëkohore) bazuar në programe të shëndosha individuale të KZhT –së, transparente, realiste dhe duke bërë të mundur aktivitetet në terren, detyra të avancuara të edukimit dhe të përfshirjes ndërkombëtare | 2013 gjysma e parë | Unike me ndikim afatgjatë (5 vjet + 2) | 1,250,000.00€të ndara në 6 qendra të përsosmërisë (vjetore) | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 5.2.1 | Krijimi i një grupi pune për të përgatitur një program financimi të hapur për të gjitha disiplinat fundamentale | 2014 gjysma e parë | Afatgjatë (deri në rishikimin e ardhshëm) | Burimet e brendshme (eventualisht ekspertizë e huaj e financuar përmes projektit austriak-KAIP) | MASHT |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës


| Kodi | Aktiviteti | Data e fillimit | Kohëzgjatja | Burimet dhe buxheti | Përgjegjësia |
|-------------|--|------------------------|--|---|--|
| 5.2.2 | Fillimi i financimit të një programi të përkrahjes të hapur për të gjitha disiplinat fundamentale | 2015 gjysma e parë | Konkursi duhet të shpallet 2 herë në vit | €1,000,000.00 për minimum 20 projekte të financuara që do të ndahen për dy vjet | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 5.3 | Ndarja e çmimeve individuale vjetor për studiuesit më të dalluar kosovarë dhe studiuesit më të mirë të rinj | 2010 gjysma e dytë | Në vazhdimësi | 30,000.00€ për pesë studiuesit më të dalluar kosovarë çdo vit dhe 10,000.00€ në vit për pesë studiuesit më të mirë rinj | MASHT (apo Agjencia Kombëtare për Promovimin e Shkencës) |
| 5.4.1 | Zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit duke u përqendruar në veprimtari kërkimore-shkencore, gjithashtu duke përfshirë parakushtet për vlerësimin e programeve, të politikave dhe të institucioneve (përfshirë arritjen e standardeve nga institute të kërkimit shkencor dhe institucione politikëbërëse). | 2011 gjysma e dytë | Pas themelimit, vazhdon zbatimi | 70,000.00€ në vit (definimin e procedurave, trajnimeve etj, eventualisht mbështetur nga projekti austriak-KAIP) | MASHT |
| 5.4.2 | Zbatimi i procesit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, duke u përqendruar në veprimtari kërkimore-shkencore, përfshirë vlerësimin e programeve, të politikave dhe të institucioneve | 2012 gjysma e dytë | Në vazhdimësi | €70,000.00 në vit | MASHT |

Shënim: të gjitha vlerësimet e buxhetit janë bazuar në vlerën nominale të vitit 2010 dhe duhet të vlerësohen në baza vjetore sipas treguesve të inflacionit.

6.2. Buxheti

Buxheti i nevojshëm për të implementuar aktivitetet të përcaktuara në këtë Program Kombëtar të Shkencës, me qëllim të arritjes së objektivave të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore dhe qenies në funksion të prioriteteve të identifikuara, karakterizohet me ngritje mjaft të madhe vjetore (shih Fig. 2). Vlen të theksohet se rënia e parashikuar në vitin 2016 do të ndodhë vetëm nëse të gjitha aktivitetet, që do të zbatoheshin përfundimisht me vitin 2015, nuk do të vazhdonin pas vitit 2015. Megjithatë, edhe në këtë rast pak të besueshëm të heqjes së instrumenteve kryesore të KZhT, për aktivitetet e filluara do të këtë detyrime buxhetore deri në vitin 2019 siç është paraqitur në Fig. 2.

Fig. 2: Kërkesat e buxhetit sipas viteve në€ për zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës deri në vitin 2015



Duke u nisur nga supozimi se të gjitha aktivitetet e implementuara në periudhën 2010-2015 do të ndërpriten nga viti 2016, Tabela 1 në faqen tjetër ofron një pasqyrë të detajuar të buxhetit. Duhet theksuar se vlerësimet buxhetore janë bazuar në vlerën nominale të vitit 2010 dhe janë valorizuar me një normë vjetore prej 5%.

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

Tab. 1: Kërkesat buxhetore sipas viteve për aktivitete nga viti 2010 deri me 2015 (me detyrime buxhetore pas vitit 2015)


| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|-------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|-------------|
| Totali i Buxhetit | 995,000.00 | 2,417,000.00 | 3,495,975.00 | 4,268,880.00 | 5,393,953.69 | 6,301,792.16 | 4,757,339.53 | 3,212,879.30 | 2,979,535.15 | 2,714,824.38 | 0.00 |
| Çmimi për hulumtuesit më të mirë të Kosovës | 40,000.00 | 42,000.00 | 44,100.00 | 46,305.00 | 48,620.25 | 51,051.26 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i parë) | 0.00 | 280,000.00 | 294,000.00 | 308,700.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | |
| Bursat vjetore për mobilitete afatshkurtra | 30,000.00 | 31,500.00 | 33,075.00 | 34,728.75 | 36,465.19 | 38,288.45 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | |
| Rrjeti i infrastrukturës kërkimore dhe labororët | 625,000.00 | 625,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Fondi Vjetor "Kthimi i Trurit " | 250,000.00 | 262,500.00 | 275,625.00 | 289,406.25 | 303,876.56 | 319,070.39 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Fondet vjetore për publikime | 50,000.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 63,814.08 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i dytë) | 0.00 | 0.00 | 294,000.00 | 308,700.00 | 324,135.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Qasje vjetore në bibliotekat elektronike | 0.00 | 210,000.00 | 220,500.00 | 231,525.00 | 243,101.25 | 255,256.31 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Fondi vjetor për përgatitjen e projekteve për FP7 | 0.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 63,814.08 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Sistemi Informativ i KZhT | 0.00 | 105,000.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Programet e doktoratës (konkursi i parë) | 0.00 | 525,000.00 | 551,250.00 | 578,812.50 | 607,753.13 | 638,140.78 | 670,047.82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Projektet ndërkombëtare të KZhT | 0.00 | 157,500.00 | 165,375.00 | 173,643.75 | 182,325.94 | 191,442.23 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Siguria e cilësisë dhe vlerësimi | 0.00 | 73,500.00 | 77,175.00 | 81,033.75 | 85,085.44 | 89,339.71 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Projektet e sigurimit të pajisjeve | 0.00 | 0.00 | 1,102,500.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i tretë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 308,700.00 | 324,135.00 | 340,341.75 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat vjetore hulumtuese të pasdoktoratës | 0.00 | 0.00 | 275,625.00 | 289,406.25 | 303,876.56 | 319,070.39 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Qendrat për Përsosmëri | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1,447,031.25 | 1,519,382.81 | 1,595,351.95 | 1,675,119.55 | 1,758,875.53 | 1,846,819.30 | 1,939,160.27 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i katërt) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 324,135.00 | 340,341.75 | 357,358.84 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|------|------|------|------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------|
| Programi i aplikuar i KZhT (konkursi e parë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 303,876.56 | 319,070.39 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Programet e doktoratës (konkursi i dytë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 607,753.13 | 638,140.79 | 670,047.83 | 703,550.22 | 738,727.73 | 775,664.11 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i pestë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 340,341.75 | 357,358.84 | 375,226.78 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Programi i kërkimeve fundamentale (konkursi i parë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 638,140.78 | 670,047.82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i gjashtë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 357,358.84 | 375,226.78 | 393,988.12 | 0.00 | 0.00 |

Me supozimin se instrumentet e prezantuara, e që janë me vlerë të përgjithshme strukturore (si çmimi për hulumtuesit më të mirë të Kosovës, programet vjetore të mobilitetit afat-shkurtër, fondi vjetor “Kthimi i trurit”, fondi vjetore për publikime, qasja vjetore në bibliotekat elektronike, fondi vjetor i përgatitjes së projekteve FP7, funksionimi vjetor i sistemit informativ të KZhT, grantet vjetore për projektet ndërkombëtare, buxheti vjetor për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, bursat shkencore të pasdoktoratës), vazhdojnë pas vitit 2015 (megjithatë, pa nisma të reja), atëherë kërkesat e nevojshme buxhetore do të stabilizohen në mes të 4.5 dhe 6.5 milionë euro në vit si shihet në Fig. 3 dhe në tabelën 2.

Fig. 3: Kërkesat e buxhetit sipas viteve në€për zbatimin e Programit Kombëtar të Shkencës me vazhdimin e aktiviteteve bazike deri në vitin 2019



Tab. 2: Kërkesat buxhetore sipas viteve për aktivitete nga viti 2010 deri në vitin 2015 dhe vazhdim të aktiviteteve bazike deri në vitin 2019

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|--|-------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Totali i Buxhetit | 995,000.00 | 2,417,000.00 | 3,495,975.00 | 4,268,880.00 | 5,393,953.69 | 6,301,792.16 | 6,281,857.86 | 4,813,623.55 | 4,660,316.61 | 4,479,644.91 |
| Çmimi për hulumtuesit më të mirë të Kosovës | 40,000.00 | 42,000.00 | 44,100.00 | 46,305.00 | 48,620.25 | 51,051.26 | 53,603.83 | 56,284.02 | 59,098.22 | 62,053.13 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i parë) | 0.00 | 280,000.00 | 294,000.00 | 308,700.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat vjetore për mobilitete afatshkurtra | 30,000.00 | 31,500.00 | 33,075.00 | 34,728.75 | 36,465.19 | 38,288.45 | 40,202.87 | 42,213.01 | 44,323.66 | 46,539.85 |
| Rrjeti i infrastrukturës kërkimore dhe laboratorët | 625,000.00 | 625,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Fondi Vjetor "Kthimi i Trurit" | 250,000.00 | 262,500.00 | 275,625.00 | 289,406.25 | 303,876.56 | 319,070.39 | 335,023.91 | 351,775.11 | 369,363.86 | 387,832.05 |
| Fondet vjetore për publikime | 50,000.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 63,814.08 | 67,004.78 | 70,355.02 | 73,872.77 | 77,566.41 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i dytë) | 0.00 | 0.00 | 294,000.00 | 308,700.00 | 324,135.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Qasje vjetore në bibliotekat elektronike | 0.00 | 210,000.00 | 220,500.00 | 231,525.00 | 243,101.25 | 255,256.31 | 268,019.13 | 281,420.08 | 295,491.09 | 310,265.64 |
| Fondi vjetor për përgatitjen e projekteve për FP7 | 0.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 63,814.08 | 67,004.78 | 70,355.02 | 73,872.77 | 77,566.41 |
| Sistemi Informativ i KZhT | 0.00 | 105,000.00 | 52,500.00 | 55,125.00 | 57,881.25 | 60,775.31 | 63,814.08 | 67,004.78 | 70,355.02 | 73,872.77 |
| Programet e doktoratës (konkursi i parë) | 0.00 | 525,000.00 | 551,250.00 | 578,812.50 | 607,753.13 | 638,140.78 | 670,047.82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Projektet ndërkombëtare të KZhT | 0.00 | 157,500.00 | 165,375.00 | 173,643.75 | 182,325.94 | 191,442.23 | 201,014.35 | 211,065.06 | 221,618.32 | 232,699.23 |
| Siguria e cilësisë dhe vlerësimi | 0.00 | 73,500.00 | 77,175.00 | 81,033.75 | 85,085.44 | 89,339.71 | 93,806.69 | 98,497.03 | 103,421.88 | 108,592.98 |

Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës

| Viti | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|---|------|------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Projektet e sigurimit te pajisjeve | 0.00 | 0.00 | 1,102,500.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i tretë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 308,700.00 | 324,135.00 | 340,341.75 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat vjetore hulumtuese të pasdoktoratës | 0.00 | 0.00 | 275,625.00 | 289,406.25 | 303,876.56 | 319,070.39 | 335,023.91 | 351,775.11 | 369,363.86 | 387,832.05 |
| Qendrat për Përsosmëri | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 1,447,031.25 | 1,519,382.81 | 1,595,351.95 | 1,675,119.55 | 1,758,875.53 | 1,846,819.30 | 1,939,160.27 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i katërt) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 324,135.00 | 340,341.75 | 357,358.84 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Programi i aplikuar i KZhT (konkursi e parë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 303,876.56 | 319,070.39 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Programet e doktoratës (konkursi i dytë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 607,753.13 | 638,140.79 | 670,047.83 | 703,550.22 | 738,727.73 | 775,664.11 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i pestë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 340,341.75 | 357,358.84 | 375,226.78 | 0.00 | 0.00 |
| Programi i kërkimeve fundamentale (konkursi i parë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 638,140.78 | 670,047.82 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Bursat e doktoratës (konkursi i gjashtë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 357,358.84 | 375,226.78 | 393,988.12 | 0.00 |

6.3. Sfidat kryesore operative

Sfidat kryesore operative për të vënë në jetë dhe zbatuar këtë Program Kombëtar të Shkencës janë:

- 1) Diskutimi me kohë dhe miratimi i Programit Kombëtar të Shkencës nga Kuvendi në gjysmën e parë të vitit 2010.
- 2) Themelimi i një grupi punues në MASHT për përgatitjen e amendamenteve ligjore për zbatimin e programeve të ndryshme dhe instrumenteve të parashikuara me Programin Kombëtar të Shkencës; eventualisht, ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe/ose plotësimi i Ligjit me një ligj më të detajuar për financimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore duke marrë parasysh praktikatat më mira dhe standardet evropiane. Kjo është ndërmarrje mjaft komplekse, por kërkon veprim urgjent për të qenë të gatshëm për konkurset e para në gjysmën e dytë të vitit 2010.
- 3) Përveç kësaj, është e nevojshme të bëhet planifikimi dhe programimi në detaje i programeve të ndryshme dhe instrumenteve të përcaktuara në Programin Kombëtar të Shkencës për t'i bërë ato operative dhe lehtë të zbatueshme. Për këtë qëllim, duhet të përgatiten rregulla të qarta, të sakta dhe transparente. Për më tepër, në proceset e planifikimit duhet të parashikohen kërkesat statistikore.
- 4) Vendimtare për suksesin ose dështimin e zbatimit të Programit Kombëtar të Shkencës është gatishmëria e MASHT-it lidhur me nisjen dhe zbatimin operativ të konkurseve për propozime, si dhe zbatimin e skemave transparente të vlerësimit. Për momentin, kapacitetet operative në MASHT nuk janë plotësisht të profesionalizuara dhe të trajnuara sipas standardeve evropiane në këtë drejtim. Parimet, rregullat, rregulloret, proceset dhe rrjedhat e programit të menaxhimit bashkëkohor të punës kërkimore, që dallon në varësi nga kërkesat e programeve të ndryshme dhe instrumenteve të propozuara në Programin Kombëtar të Shkencës, duhet të zbatohen në kohën e duhur, si dhe të organizohet trajnim dhe krijohet përvojë për to. Rekomandohet fuqimisht asistencë nga partnerët e huaj. Përfundimisht, MASHT-i duhet të kombinojë forcat tashmë të trajnuara pjesërisht nga QKBNSHT (Qendra e Kosovës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Arsim, Kërkim dhe Bashkëpunim Teknologjik) dhe QITT (Qendra për inovacione dhe Transfer të Teknologjisë), të cilat janë themeluar në kuadër të projektit austriak- KAIP, në një Agjenci të Promovimit Kombëtar të Shkencës dhe me një staf prej minimum 5 të punësuar me orar të plotë.
- 5) Vlerësimi i propozimit të projekteve të paraqitura duhet të bëhet në një mënyrë shumë transparente për të shmangur "optikën e gabuar" dhe mosbesimin që nga fillimi. Komisionet e vlerësimit duhet të reflektojnë pronësi të fuqishme të vetë komunitetit shkencor në Kosovë, por rekomandohet që të ndërtohet një partneritet strategjik me një agjenci të huaj për promovimin e shkencës në mënyrë që të angazhohen vlerësues të huaj, që nuk janë të integruar në rrjetet shoqërore të hulumtuesve shkencorë të Kosovës. Që nga fillimi, propozimet e projektit duhet të jenë të shkruara në anglisht, lingua franca e shkencës dhe teknologjisë.
- 6) Secili prej programeve dhe instrumenteve kryesore të përcaktuara në Programin Kombëtar të Shkencës duhet të monitorohet dhe të vlerësohet me kujdes. Prandaj, kërkesat për vlerësim duhet të parashihen gjatë hartimit të rregullave të detajuara dhe rregulloreve të programeve dhe të instrumenteve që do të zbatohen. Që nga fillimi duhet të kultivohet një kulturë vlerësuese profesionale të KZhTI në përputhje me praktikatat më mira evropiane,

si dhe të përfshihen ekspertë vlerësimi të trajnuar nga kolegë të huaj (p.sh. brenda programit të partneritetit austriak- KAIP).

- 7) Edhe pse kërkesat buxhetore për 5 vitet e ardhshme janë, në shikim të parë, sfiduese, ekziston kërkesa ligjore për të rezervuar deri në 0.7% të buxhetit kombëtar për veprimtari kërkimore-shkencore. Megjithatë, pritet një rritje e shpejtë e alokimeve dhe shpenzimeve buxhetore të parashikuara si është shpjeguar në seksionin e mëparshëm. MASHT-i ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të planifikuar më herët dhe për të garantuar një zbatim pa pengesa dhe pa ndërprerje, duke siguruar një fleksibilitet në kërkesat buxhetore për të trajtuar çështje të reja, që nuk janë objekt shqyrtimi për momentin.

Shtojca 1: Lista e ekspertëve që kanë marrë pjesë në hartimin e Programit

1. Adem Demaj, UP
2. Agim Gashi, UP
3. Arben Mehmeti, UP
4. Ardiana Gashi, Kolegji “Fama”
5. Avdulla Alija, MASHT
6. Avdyl Krasniqi, KKSH
7. Bekim Berisha, Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës
8. Burim Neziri, UP
9. Dragoslav Pejçinovi, Instituti Ekoman
10. Dukagjin Pupovci, KKSH
11. Fetah Halili, UP
12. Fetah Podvorica, KKSH
13. Frashër Demaj, Instituti i Historisë
14. Hasnije Ilazi, UP
15. Hysen Bytyqi, UP
16. Hysen Matoshi, Instituti Albanologjik
17. Helmuth Karner, Ekspert i KAIP
18. Isuf Krasniqi, KKSH
19. Jahja Drançolli, KKSH
20. Jehona Lushaku, KAIP
21. Johann Guenther, KAIP
22. Kadri Sylejmani, UP
23. Klaus Schuch, Ekspert i KAIP
24. Kujtim Kërveshi, UP
25. Lindita Tahiri, Zyra Kombëtare e Tempus-it
26. Lule Ahmedi, UP
27. Muhamet Sadiku, Instituti Riinvest
28. Murteza Osdautaj, MASHT
29. Naim Hasani, Qendra për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë
30. Naser Zabeli, UP
31. Nexhmi Rexha, KKSH
32. Radivoje Maniç, KKSH
33. Ragip Kastrati, UP
34. Raif Bytyqi, Instituti INKOS
35. Rame Likaj, UP
36. Ramë Vataj, MASHT
37. Ramush Mavriqi, UP
38. Rexhep Ferri, KKSH
39. Rexhep Gjergji, UP
40. Rexhep Ismajli, KKSH
41. Shaip Krasniqi, UP
42. Shemsi Krasniqi, UP
43. Skender Kaçiu, KKSH
44. Suzana Kërliu, KSH
45. Valon Murati, Qendra për të Drejtat e Njeriut UP
46. Xhevat Perjuci, KKSH
47. Zejnullah Gruda, KKSH
48. Zejnullah Rrahmani, KKSH

Mbështetje logjistike:

Anita Rukovci, MASHT
Bekim Behrami, Përkthyes i KAIP
Esma Basholli, Përkthyes i
MASHT
Faton Hamiti, Përkthyes i KAIP
Sebahate Jupolli, MASHT
Shaip Hoxha, Përkthyes i MASHT

Aneksi 2: Literatura

Ahmedi, L. and Sylemani, K. (2009): National Background Report on ICT Research in Kosovo. WBC-INCO.net, November 2009. Available from: www.wbc-inco.net/attach/KosovoICTReportFINAL_01_12_2009.pdf, accessed on 3.2.2010.

Kuvendi i Kosovës (2002): Ligji Nr. 2002/3 për Arsimin e Lartë në Kosovë 26.09.2002, dekretuar me Rregulloren 2003/14. Available from: <http://www.cepes.ro/hed/policy/legislation/pdf/Kosovo.pdf>, as accessed 18.03.2008.

Kuvendi i Kosovës (2004): Ligji Nr. 2004/42 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore i datës 27.09.2004. Available from: http://www.unmikonline.org/regulations/2005/RE2005_08_ALE2004_42.pdf, as accessed 18.03.2008.

Borsi, B., Dévai, K., Papanek, G. and Rush, H. (2004): The RECORD Manual. Benchmarking Innovative Research Organisations in European Accession Countries. Luxembourg, Office for Official Publications of the European Communities.

Gassler, H., Polt, W. und Rammer, C. (2006): Schwerpunktsetzungen in der Forschungs- und Technologiepolitik - eine Analyse der Paradigmenwechsel seit 1945. Österreichische Zeitschrift für Politikwissenschaft, 35. Jg., 2006/1, S. 7-23.

IDC Adriatics (2008): Kosovo IT Market 2008-2012 Forecast and 2007 Vendor Shares. Available from: http://www.idc-cema.com/index.php?showproduct=%201818722&content_lang=ENG, accessed 3.2.2009.

Institute of Albanology (2007a): Activity. Available from: <http://albanolog.com/activity.html>, as accessed 4.1.2008.

Martin, B. and Nightingale, P. (2000): Introduction. In: Martin, B. and Nightingale, P. (eds.): The Political Economy of Science, Technology and Innovation. Cheltenham and Northampton: Elgar (The International Library of Critical Writings in Economics), pp. XIII-XLII

MASHT (2004): Strategjia për zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015. Available from: <http://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/6/22.pdf>, as accessed 20.07.2007.

Mustafa, I., Hoti, A., Gashi, P., Demukaj, V., Havolli, Y., Kotorri, M. et al. (2004): Education and Economic Development of Kosovo. Prishtina: Institute for Development Research (RIINVEST). Available from: <http://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/20/7.pdf>, as accessed 18.03.2008.

OSCE (2008): Roadmap for improved university policies and procedures for faculty appointment, retention, promotion and tenure and better support and stimulation to increase qualitative and quantitative scholarly research activity at the University of Prishtina.

Schuch, K. (2008): Science and Technology in Kosovo/UNMIK. Thematic Report of the Information Office of the Steering Platform on Research for the Western Balkan Countries. In: Dall, E. (ed.): Science and Technology in the Western Balkans. Brno: Barrister and Principal, pp. 272-303.

Tahirsylaj, A. (2004): Higher Education in Kosovo: Major Changes, Reforms and Development Trends in Post-conflict Period at University of Prishtina. Available from: http://www.see-educoop.net/education_in/pdf/high-educ-kos-enl-t02.pdf, as accessed.

Universiteti i Prishtinës (2009): Strategjia/Strategy 2009-2013. Publikuar nga MASHT dhe UP.

Universiteti i Prishtinës (2004): Statuti i Universitetit të Prishtinës